

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5658
E enjte, 20 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

LDK-ja nuk bëhet pjesë e ekipit negociator

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 4-5

LDK-ja e Vetëvendosja të reflektojnë, të bëhen pjesë e dialogut

Ministri i Infrastrukturës, njëherësh nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, i ka bërë thirrje Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV) që të reflektojnë karshi dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto subjekte politike duhet të heqin dorë nga interesat e ngushta partiake dhe të bëhen pjesë e ekipit negociator i cili është votuar në Kuvendin e Kosovës. Sipas tij, unifikimi i skenës politike rreth kësaj çështje do ta ndihmojë Kosovën. Lekaj ka hedhur poshtë kritikën se delegacioni aktual nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm. Ai ka thënë se ky ekip negociator ka legjitimitet të plotë pasi është miratuar nga Kuvendi me shumicë të votave



AKTUALE

A MUND TË PAJTOHET KOSOVA ME SERBINË, ME LETRA DHE KËRCËNIME?! F. 12



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

INJORANCË APO LAJTHITJE NË KËSHILLIN E SIGURIMIT OSE PËRKUJTIET PËR DISA ANËTARË NË KS F. 11



Jakup KRASNIQI

KURTI: INTEGRIMI EVROPIAN ËSHTË DREJTUAR NË NJË RRUGË TË GABUAR F. 6

EKONOMI



PRODIMI VENDOR NUK MJAFTON, NEVOJITEN KAPACITETE TË REJA NË SEKTORIN E ENERJISË F. 8

DOGANA KONFISKON DUHAN PA BANDEROLA DHE ARRESTON NJË PERSON TË DYSHIMTË F. 8

SPORT

DAUTAJ: FERIZAJ NUK KA FRIKË NGA FERONIKELI, SYNON GJYSMËFINALIN F. 15

LLAPI BRENDA DITËS NDAHET ME SHOTANIN, MERR REXHEPIN F. 15



Liderët e rajonit inkurajojnë arritjen e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi

Presidenti i vendit, Hashim Taçi, ka bërë me dije të mërkurën se Kosova është e gatshme për marrjen e vendimeve të mëdha që i kontribuojnë forcimit të

paqes në rajon. Ai ka thënë se në këtë kuadër është edhe arritja e marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe

Serbisë. Këto komente presidenti Taçi i ka bërë pas takimit në mes të liderëve të Ballkanit Perëndimor me përfaqësuesit e lartë të BE-së në Bruksel | FAQE 3

Veseli kërkon nga BE-ja t'i trajtojë barabartë Kosovën dhe Serbinë | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Haradinaj: Kosova do të punojë ngushtë me NATO-n

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka treguar për bisedën telefonike që ka zhvilluar me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg.

Haradinaj ka bërë me dije se është i kënaqur me përkushtimin e NATO-s për të mbështetur Kosovën në tërësi.

"Sot, kam zhvilluar një bisedë miqësore telefonike me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe jam i kënaqur me përkushtimin e NATO-s për të mbështetur Kosovën në tërësi. Me kënaqësi e informova sekretarin Stoltenberg për miratimin e lig-

jeve për Ministrinë e Mbrojtjes, mandatimin ushtarak të FSK-së dhe shërbimin në FSK. Po ashtu, e informova për veprimin konkret të Qeverisë së Kosovës në themelimin e Komitetit Ndërmintor për Integritet dhe Anëtarësimin në NATO, si një zhvillim konkret për afrimin e Kosovës me NATO-n", ka shkruar Haradinaj.

Ai ka theksuar se e ka garantuar sekretarin Stoltenberg për transparencën e procesit të transicionit të FSK-së, duke shprehur vizionin e tij dhe të Qeverisë për thellimin e partneritetit me NATO-n, KFOR-in, NALT-in, Programin e Ndërveprimit të Zgjeruar dhe për gatishmërinë e trupave të

FSK-së për të kontribuar në sigurinë rajonale dhe globale.

"Kosova do të punojë ngushtë me NATO-n për t'i përmbushur kapacitetet e plota operacionale të FSK-së në mandatin ushtarak, si dhe për angazhimin e përbashkët në ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes", ka thënë kryeministri Haradinaj. Kurse në njoftimin për mediet të NATO-s thuhet se sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka zhvilluar një bisedë telefonike me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj për transformimin e FSK-së në ushtri.

Stoltenbergu e ka njoftuar Haradinajn se Këshilli Veri-Atlantik ka pasur një diskutim fillestar mbi ligjet e



miratuara së fundmi mbi transicionin Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

"Sekretari i përgjithshëm e ka njoftuar Haradinajn se tani që mandati i FSK-së po evoluon, Këshilli Veri-Atlantik do të rishqyrtojë nivelin e angazhimit të NATO-s me FSK-në vitin e

ardhshëm. NATO-ja do të vazhdojë me misionin e saj të KFOR-it për të siguruar ambient të sigurt në Kosovë. KFOR-i operon në bazë të mandatit të OKB-së dhe nuk do të preket nga ligjet mbi transicionin e FSK-së", është thënë në njoftimin e NATO-s.

LDK-ja nuk bëhet pjesë e ekipit negociator

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se kjo parti do të jetë faktor korrektues i vendimeve që merren në Kuvendin e Kosovës, në këtë mënyrë edhe i procesit të dialogut me Serbinë duke mos qenë pjesë e ekipit negociator

"Epoka e re"

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, gjatë një konference për media të mërkurën në mbrëmje ka bërë me dije se kjo parti do të luajë rolin e saj si parti opozitare në Kuvend, duke qartësuar se këtë rol do ta luajë edhe sa i përket dialogut me Serbinë.

Mustafa ka thënë se institucionet e vendit duhet të kenë legjitimitet edhe për procesin e dialogut me Serbinë.

Ai ka theksuar se institucionet duhet ta fitojnë legjitimitetin duke shkuar në zgjedhje të reja. "LDK-ja ka pranuar pozicionin e saj si parti opozitare.

Jemi munduar dhe do të mundohemi edhe më tutje që në Kuvendin e Republikës së Kosovës të jemi faktor korrektues i vendimeve që merren në Kuvend, në mënyrë që të gjitha këto vendime të jenë në interes të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj. Këtë rol LDK-ja e ka konfirmuar edhe më parë se do ta mbajë edhe sa i përket dialogut me Serbinë. Kjo nuk është ikje nga përgjegjësia por është marrje e përgjegjësisë që nga opozita t'i kontribuojë dialogut dhe çdo marrëveshje e cila do të ishte në interes të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve. Ne jemi të gëzuar për përkrahjen që këtij procesi i kanë dhënë edhe më herët dhe tash ShBA-ja, si vend me të cilin presidenti ynë Ibrahim



Rugova gjithmonë ka theksuar se duhet të kultivojmë miqësi të përhershme. Pra e vlerësojmë interesimin e presidentit të ShBA-së që procesi i dialogut të shkojë përpara dhe të jetë në interes të Kosovës. Po ashtu shohim përgjegjësinë e institucioneve të Republikës së Kosovës se për këtë dialog ato duhet të kenë legjitimitet politik dhe legjitimitet qytetar, dhe ne si LDK kemi theksuar se këtë legjitimitet më së miri do

ta fitonin përmes votës së lirë të qytetarëve të Kosovës", ka thënë Mustafa.

I pyetur nëse LDK-ja do të bëhet pjesë e ekipit negociator, Mustafa ka thënë se kjo parti do ta ndihmojë këtë proces vetëm si parti opozitare brenda Kuvendit. "Përkrahjen e dialogut e shohim si opozitë. Ne kemi thënë që nga fillimi se çështja e dialogut është çështje e institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjithmonë kemi

konstatuar se negociatat duhet t'i zhvillojë Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne do të mbajnë pozitën tonë si opozitë, dhe do të veprojmë në opozitë, dhe si opozitë do t'i kontribuojmë dialogut", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se LDK-së i takojnë dy vende në KQZ. Sipas tij, në këtë proces presidenti i vendit ka bërë shkelje duke shkelur afatet sa i përket emërimit të anëtarëve në KQZ.

Basha: Tash nisim rezistencën

TIRANË, 19 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha u ka bërë thirrje qytetarëve që të dalin sot (e enjte) në protestë e t'u bashkohen studentëve.

Ai kërkoj nga qytetarët të mblidhen te Kuvendi dhe të nisin aty rezistencën.

"Sot ju e keni parë se si plani urbanistik i Tiranës është



ndryshuar nga Veliaj dhe është miratuar nga Edi Rama. Ndryshimi i këtij plani konsiston në ndryshimin e rrjedhjes së lumit

Lana. Në fakt është një bandë që nuk ka asnjë qëllim për vendin përveç grabitjes. Kjo është arsyeja pse këta njerëz janë në protestë. Shqipërinë e konsiderojnë thjesht dhe vetëm si një koloni ku grabisin gjithçka dhe deri në palcë qytetarët. Nuk është vetëm një çështje tarifash. Është çështja e një sistemi të ngritur nga Edi Rama ku

politikanë, kriminelë e pedagogët të korruptuar kanë në dorë fatin e 140 mijë të rinjve e qindra mijëra të tjerëve që do vijnë. Ata nuk mund të jenë peng i kësaj klike të korruptuar. Me gjithë këto të zeza që do kishin rrëzuar çdo qeveri evropiane sot dua të ndaj me shqiptarët dy lajme të mira. Nuk ka rrugë tjetër veç përballjes. E

patë si ishte katandisur sot Edi Rama në Vlorë. E ka kuptuar se askush nuk ia blen më gënjeshttrat. Nuk e beson më askush. Kanë vendosur të mos negociojnë sepse e kanë kuptuar se ky o do përpiqet t'i blejë negociatorët ose do i mashtrorë. 60 milionë euro është afera Veliaj-Bego", deklaroi Basha.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për medie pas takimit në mes të liderëve të rajonit me përfaqësuesit e lartë të Bashkimit Evropian

Liderët e rajonit inkurajojnë arritjen e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka bërë me dije të mërkurën se Kosova është e gatshme për marrjen e vendimeve të mëdha që i kontribuojnë forcimit të paqes në rajon. Ai ka thënë se në këtë kuadër është edhe arritja e marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këto komente presidenti Thaçi i ka bërë pas takimit në mes të liderëve të Ballkanit Perëndimor me përfaqësuesit e lartë të BE-së. Sipas tij, liderët e rajonit kanë inkurajuar Kosovën dhe Serbinë për arritjen e marrëveshjes finale. Thaçi ka shprehur optimizëm se kjo marrëveshje do të mund të arrihet në një të ardhme të afërt

këtë takim i kanë dhënë mbështetje mundësisë së arritjes së marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Sa i përket çështjes së mundësisë për arritjen e marrëveshjes finale gjithëpërfshirëse me njohje reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë është inkurajues fakti se të gjithë liderët e rajonit mbështesin përpjekjet e Kosovës dhe të Serbisë për arritjen e një marrëveshje finale duke konkluduar se arritja e një marrëveshje të tillë do të prodhojë më tepër paqe, stabilitet dhe frymë evropiane në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe do t'i përshpejtojë proceset evropiane për Kosovën edhe në NATO, edhe në BE, ndërsa për Serbinë të ardhme evropiane. Kosova definitivisht do ta rrisë konsolidimin në rrafshin ndërkombëtar duke fituar njohjen nga Serbia dhe menjëherë do të pasojnë njohjet nga pesë vendet e BE-së, fillimi i ndryshimit të Rezolutës 1244 dhe anëtarësimi i Kosovës në OKB. Nëse ka pasur hezitime para pak muajsh nga faktorë të ndryshëm, sot të gjithë janë unikë, edhe BE-ja, edhe ShBA-ja dhe faktorët e tjerë për rëndësinë e dialogut Kosovë - Serbi dhe për rëndësinë e arritjes së marrëveshjes finale", ka theksuar Thaçi.

Ai ka shprehur optimizëm se me mbështetjen e BE-së dhe të ShBA-së marrëveshja finale

Kosovë - Serbi do të arrihet në një të ardhme të afërt. "Unë shpresoj dhe besoj se marrëveshja mund të arrihet në të ardhmen e afërt. Ky mobilizim i faktorit ndërkombëtar i ShBA-së dhe BE-së është mesazhi më i mirë për neve në Kosovë se ne duhet të punojmë bashkërisht, duhet që ekipi negociator ta fillojë punën menjëherë, të përgatitet edhe më mirë, t'i krijojë ekipet profesionale, të komunikojë me qytetarët që të kemi një proces krejt transparent dhe me një përfshirje sa më të gjerë politike", është shprehur Thaçi, duke shtuar se letra e presidentit Donald Trump është shprehur dhe besim për institucionet e Republikës së Kosovës. Madje, sipas tij, nuk ka lider në Kosovë që i thotë jo presidentit Trump. "Letra e presidentit Trump është zëri i Amerikës, është mbështetja e plotë dhe unike e ShBA-së për Kosovën dhe rajonin. Prandaj nëse dikush ka pasur hezitime deri tani për rolin e ShBA-së kjo tregon dhe dëshmon qartë me fakte se ShBA-ja është e përfshirë në proces të mbështetjes së plotë për mundësinë e arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi. Kështu që liderëve të Kosovës u mbetet të punojnë me përgjegjësi të lartë shtetërore dhe kombëtare për një marrëveshje të pranueshme dhe të implementueshme. Nuk besoj se ka lider në Kosovë që i thotë

jo presidentit Trump. Jemi shumë liderë të vegjël në Kosovë për t'i dalë përballë opinionit dhe qëndrimit të ShBA-së. Letra e presidentit Trump është qëndrim i ShBA-së", ka deklaruar Thaçi. Ai ka bërë me dije se deri në fillim të vitit të ardhshëm nuk pritet të ketë takime në kuadër të dialogut.

Ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, u ka thënë zyrtarëve të lartë të Bashkimit Evropian se Serbia është e angazhuar për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën mirëpo, sipas tij, e vetmja mënyrë për ta vazhduar dialogun me Prishtinën është nëse tërhiqet tarifa prej 100 përqindësh për mallrat serbe. "Serbia është e angazhuar për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal dhe e vendosur për të kontribuar në këtë drejtim. Një parakusht për zbatimin e suksesshëm dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal është respektimi rigoroz i të gjitha marrëveshjeve të nënshkuara në pajtim me të gjithë pjesëmarrësit në rajon. E vetmja mënyrë për të krijuar kushtet në të cilat vazhdimi i bisedimeve do të ishte i mundur është që Prishtina të tërhiqet nga vendime të paligjshme dhe krejtësisht të paarsyeshme", ka thënë presidenti Vučić pas takimit me presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk.

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini dhe komisionari për zgjerim Johannes Hahn të mërkurën kanë qenë nikoqirë të takimit në mes të liderëve të rajonit ku është diskutuar për zhvillimet e fundit në rajon. Pas këtij takimi presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur një konferencë me gazetarë, ku ka bërë me dije se ka një mobilizim të faktorëve ndërkombëtarë dhe atyre rajonalë për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova është e angazhuar për një Ballkan Perëndimor funksional si dhe është e gatshme për vendime të

mëdha që e forcojnë paqen dhe stabilitetin në rajon. "Në takimin me liderët e Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësuesen e lartë të BE-së, Federica Mogherini, e rikonfirmova gatishmërinë tonë për dialog dhe marrëveshje paqësore me Serbinë, sepse pa një marrëveshje përfundimtare do të shndërrohemi në vende që prodhojnë drama të panevojshme për konsum të brendshëm elektoral. Ne të gjithë duhet të mendojmë më shumë për gjeneratat e ardhshme, jo për zgjedhjet e ardhshme dhe së bashku duhet ta fitojmë betejën për të ardhmen tonë, për paqen, duke përmbyllur njëherë e përgjithmonë konfliktin shekullor mes popujve tanë", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se liderët e rajonit në

Flet për "Epokën e re", Pal Lekaj

LDK-ja e Vetëvendosja të reflektojnë, të bëhe



Ministri i Infrastrukturës, njëherësh nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, i ka bërë thirrje Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV) që të reflektojnë karshi dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto subjekte politike duhet të heqin dorë nga interesat e ngushta partiake dhe të bëhen pjesë e ekipit negociator i cili është votuar në Kuvendin e Kosovës. Sipas tij, unifikimi i skenës politike rreth kësaj çështje do ta ndihmojë Kosovën. Lekaj ka hedhur poshtë kritikën se delegacioni aktual nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm. Ai ka thënë se ky ekip negociator ka legjitimitet të plotë pasi është miratuar nga Kuvendi me shumicë të votave

se është qëndrim mburravec i kësaj partie, i cili nuk i kontribuon formimit të shtetit të Kosovës", është shprehur Lekaj. Ai ka hedhur poshtë kritikën se delegacioni aktual nuk ka legjitimitet të mjaftueshëm. "Delegacioni i Kosovës mendoj se ka legjitimitet të plotë, sepse shumica e deputetëve në Kuvend kanë votuar pro këtij delegacioni shtetëror. Pavarësisht prej mendimeve të ndryshme të opozitës, mendoj se në këtë drejtim nuk ka vend për kritika, sepse edhe ata janë të vetëdijshëm se, nëse kërkohet një rezolutë që të miratohet ajo miratohet me shumicën e thjeshtë të votave në Kuvend. Në këtë mënyrë grupi negociator i ka marrë 61 vota dhe askush nuk mund ta kontestojë legjitimitetin e tij. Prandaj, mendoj se ky delegacion është legjitim dhe kritikën nga opozita nuk kanë vend.

se shumica e deputetëve në Kuvend kanë votuar pro këtij delegacioni shtetëror. Pavarësisht prej mendimeve të ndryshme të opozitës, mendoj se në këtë drejtim nuk ka vend për kritika, sepse edhe ata janë të vetëdijshëm se, nëse kërkohet një rezolutë që të miratohet ajo miratohet me shumicën e thjeshtë të votave në Kuvend. Në këtë mënyrë grupi negociator i ka marrë 61 vota dhe askush nuk mund ta kontestojë legjitimitetin e tij. Prandaj, mendoj se ky delegacion është legjitim dhe kritikën nga opozita nuk kanë vend.

"Epoka e re": Kritikën kanë të bëjnë me shumë me mospërfshirjen e dy subjekteve më të mëdha opozitare?

Lekaj: Më mirë do të ishte që opozita të bëhet pjesë e këtij delegacioni negociator dhe t'i lë anash interesat partiake. Në këtë mënyrë Kosova do të ishte e bashkuar në këtë delegacion i cili do të ketë mandat të bisedojë me Serbinë për fazën finale të dialogut. Kjo do të ndihmonte që

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË 19 DHJETOR - Ministri i Infrastrukturës, njëherësh nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka ftuar dy subjektet më të mëdha opozitare, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjen Vetëvendosje (LV), që të heqin dorë nga interesat e ngushta dhe të bëhen pjesë e delegacionit të Kosovës për dialog. Ai ka thënë se në fazën finale të dialogut me Serbinë është në pyetje interesi kombëtar i

Kosovës dhe në këtë mënyrë spektri politik duhet të paraqitet unik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se unifikimi i skenës politike rreth kësaj çështje është shumë me rëndësi për Kosovën. "Në këtë mënyrë Kosova do të ishte e bashkuar në këtë delegacion i cili do të ketë mandat të bisedojë me Serbinë për fazën finale të dialogut. Kjo do të ndihmonte që Kosova të kishte një qëndrim unik në këtë proces dhe të dilte fitimtare. Unë i bëj ftesë opozitës të reflektojë dhe të fillojë të mendoj ndryshe dhe të

largohet nga ato botëkuptimet dhe interesat elektorale", ka thënë Lekaj.

Nënkryetari i AAK-së është shprehur i befashuar me qëndrimin e LDK-së ndaj kësaj çështje. Sipas Lekajt, qëndrimi i këtij subjekti politik ndaj dialogut është mburravec. "Besoni se çuditë me qëndrimin e LDK-së. Kur ky subjekt vazhdimisht thirret se është subjekt institucionalist dhe se punon për të mirën e vendit, ndërsa tani kur në fazën finale të dialogut duhet të jemi të bashkuar, disi tërhiqet. Mendoj

"Epoka e re": Z. Lekaj, Kuvendi i Kosovës me votat e koalicionit qeverisës dhe të PSD-së ka miratuar javën e kaluar rezolutën për dialogun dhe delegacionin negociues. Por ky i fundit po kritikohet për moslegjitimitet të plotë?

Lekaj: Delegacioni i Kosovës mendoj se ka legjitimitet të plotë

n pjesë e dialogut

"Epoka e re": Tani kemi letrën e presidentit Trump e cila e nxit spektrin politik që të jetë unik për marrëveshjen historike me Serbinë. Cila duhet të jetë përgjigjja e skenës politike ndaj këtij mesazhi të presidentit amerikan?

Lekaj: Jo vetëm për spektrin politik, por për të gjithë qytetarët e Kosovës kjo letër është një mesazh i mirë se Amerika qëndron në anën e Kosovës dhe punon për ta forcuar shtetin e Kosovës. Kështu që, duhet përshëndetur letra e presidentit Trump drejtuar presidentit të Kosovës. Përsëri shteti amerikan po tregon angazhimin e tij të madh që ka për Kosovën. Kjo tregon se edhe në këtë fazë të dialogut shteti amerikan dëshiron që Kosova të dalë si shtet i fuqishëm dhe stabil.

"Epoka e re": Pas vendimit të Qeverisë për taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe dhe vendimit për formimin e ushtrisë kemi parë një përplasje të Qeverisë me BE-në. Mund t'i konsiderojmë si të acaruar raportet Kosovë - BE?

Lekaj: Qëndrimi i kryeministri të Kosovës dhe Qeverisë karshi BE-së është i drejtë dhe legjitim. Këto janë qëndrime të një shteti sovran dhe nuk shoh se ka ndonjë acarim të raporteve. Nëse t'i merr qëndrime sovraane dhe vendime që shkojnë në favor të qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik të shtetit tënd, atëherë ai vendim është i drejtë. Pastaj veprimet tona kanë ardhur si kundërpërgjigje ndaj palës serbe, e cila për vite me radhë nuk i ka respektuar marrëveshjet që i ka nënshkruar me Kosovën. Pra, ky nuk është acarim, por një vendim sovran i republikës dhe kështu duhet të vazhdohet. Për herë të parë një Qeveri legjitime e shtetit të Kosovës po tregon vendosmëri dhe guxim që edhe karshi BE-së ta thotë të vërtetën në mënyrë të qartë.

"Epoka e re": Këto veprime të Qeverisë a mund të sjellin ndonjë pasojë për Kosovën?

Lekaj: Nuk mendoj se do të ketë pasojë, sepse për ne udhërrëfyesi i demokracisë ka qenë dhe është Evropa. Në këtë drejtim besoj se do të kemi mbështetje. Po e përsëris me plot kuptimin e fjalës se Kosova ka vetëm një drejtim dhe një biletë, ajo është BE-ja. Ne nuk kemi alternativë tjetër, mirëpo edhe BE-ja duhet të tregohet serioze karshi Kosovës dhe të mos ta prekë mendësinë e qytetarëve që ata të fillojnë të mendojnë ndryshe. Atëherë ku preket mendësia e qytetarëve, mendoj se gjithçka ka përfunduar. Çdokush duhet ta dijë se qytetarët tanë dhe shteti i Kosovës janë populli dhe shteti më pro perëndimor në botë.

Kosova të kishte një qëndrim unik në këtë proces dhe të dilte fitimtare. Unë i bëj ftesë opozitës që të reflektojë dhe të fillojë të mendojë ndryshe dhe të largohet nga ato botëkuptimet dhe interesat elektorale. Tani është në pyetje marrëveshja me Serbinë dhe nga ky proces Kosova do të dalë si shtet i pavarur dhe me territor që ia përcakton Kushtetuta dhe si shtet i njohur nga Serbia.

"Epoka e re": LDK-ja e cila vazhdimisht e ka përkrahur procesin e dialogut tani po e kundërshton. Pse mendoni se po vepron në këtë mënyrë?

Lekaj: Besoni se çuditë me qëndrimin e LDK-së. Kur ky subjekt vazhdimisht thirret se është subjekt institucionalist dhe se punon për të mirën e vendit, ndërsa tani kur në fazën finale të dialogut duhet të jemi të bashkuar, disi tërhiqet. Mendoj se është qëndrim mburravec i kësaj partie, i cili nuk i kontribuon formimit të shtetit të Kosovës.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mbajtur konferencë për medie

Veseli kërkon nga BE-ja t'i trajtojë barabartë Kosovën dhe Serbinë

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka bërë me dije se taksa ndaj produkteve serbe nuk do të hiqet derisa Bashkimi Evropian (BE) t'i trajtojë në mënyrë të barabartë Kosovën dhe Serbinë. Të mërkurën në një konferencë me gazetarë ai ka vlerësuar se reciprociteti do të jetë baza e vendimeve për ecjen përpara

EPOKA E RE

Shqipëri HETEMI

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të mërkurën se reciprociteti do të jetë baza e vendimeve për ecjen përpara. Në këtë kontekst, ai ka deklaruar se taksa ndaj produkteve serbe nuk do të hiqet derisa BE-ja t'i trajtojë në mënyrë të barabartë Kosovën dhe Serbinë. "Serbia duhet ta kuptojë se Kosova është shtet i pavarur dhe është e detyruar të jetojë me këtë fakt. Nëse s'e kupton, ne do ta bëjmë që ta ndiejë shtetin e Kosovës çdo ditë e më shumë. Ne presim nga BE-ja që në dialog të garantojë parimin e trajtimit të barabartë të palëve dhe përfitimet e dyanshme prej tij. Ne presim nga BE-ja që ta trajtojë seriozisht dhe në mënyrë të balancuar çështjen e bllokadave të dyanshme. Kosova nuk do të veprojë njëanshëm në heqjen e taksës. Taksa nuk është problemi i vetëm dhe as më i madhi. Trajtimi i barabartë dhe reciprociteti janë rrugëzgjdhja", ka thënë Veseli në një konferencë me gazetarë.

Ai ka vlerësuar se thirrjet e BE-së për heqjen e taksës pa i bërë thirrje edhe Serbisë që të heqë dorë nga qasja e saj bllokuese po i shqetëson me të drejtë qytetarët e Kosovës. "Serbia gjithë kohën ka bërë obstrukcione për zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri më tash në dialog. Mallrat e Kosovës asnjëherë nuk kanë mundur të lëvizin lirshëm në Serbi, ndërsa mallrat e Serbisë kanë hyrë në Kosovë pa respektuar ligjet e shtetit tonë. Serbia ka vazhduar me agresivitet ta pengojë integrimin e Kosovës në institucionet dhe mekanizmat ndërkombëtarë. Rasti më i fundit ishte Interpoli. Kjo, për rrjedhojë, solli vendosjen e taksës 100 për qind për produktet serbe. Kjo masë ishte reagim për të treguar se bllokimi sjell bllokim të dyanshëm. Kemi pritur reflektim balancues të BE-së për këtë situatë, që ul tensionet dhe mohon politikën bllokuese për dy palët njësoj. Nuk kemi pritur që BE-ja të reagojë vetëm ndaj nesh", është shprehur Veseli. Ai ka theksuar se BE-ja nuk mund ta shikojë Kosovën nga

perspektiva integruese e Serbisë. Sipas Veselit, rruga e Kosovës për në Bruksel nuk do të kalojë përmes Beogradit. "Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Bashkimi Evropian nuk mund që Kosovën ta shikojë nga perspektiva integruese e Serbisë. Rruga e Kosovës për në Bruksel nuk kalon, as nuk ka për të kaluar përmes Beogradit. Bllokimi i lëvizjes përpara në agjendën e Bashkimit Evropian përbën shqetësim serioz. Ai mund të ketë pasojë ndëshkuese për Kosovën, por në asnjë mënyrë nuk e ndihmon stabilitetin në rajon dhe as vetë BE-në. Izolimi i qytetarëve të Kosovës pa lëvizje të lirë vetëm sa e rëndon më shumë këtë situatë", ka theksuar kryeparlamentari Veseli. Votimin e transformimit të FSK-së në ushtri dhe votimin e ekipit negociator Veseli e ka quajtur vendime të mëdha për Kosovën. Kryeparlamentari Veseli ka folur edhe për letrën të cilën presidenti amerikan, Donald Trump, ia ka dërguar presidentit Hashim Thaçi, duke thënë se me këtë letër ShBA-ja i ka bërë nder Kosovës.

Deri më 15 janar procedohet në Qeveri draftligji për dialogun

PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - Delegacioni shtetëror i Kosovës për dialogun me Serbinë ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e parë, në të cilën ka diskutuar për ecurinë e këtij procesi. Pas kësaj mbledhje, në një konferencë për media janë paraqitur Shpend Ahmeti dhe Fatmir

Limaj. Shpend Ahmeti, i cili është bashkëkryesues i delegacionit të Kosovës në dialog me Serbinë së bashku me Fatmir Limajn, ka shpalosur detaje të tjera rreth organizimit të punës. "U morëm vesh që një herë unë dhe një herë Limaj t'i kryesojmë takimet. U pajtuam që

deri më 15 janar ta procedojmë draftligjin në Qeverinë e Kosovës. Brenda 30 ditësh delegacioni duhet ta përfaqësojë dialogun me Serbinë. Pesë anëtarë do të punojnë në platformë", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se kryesorja për ekipin negociator është procedimi i draftligjit.



FSK-ja bëhet me helikopter për qëllime trajnimi

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtimin e Regjimentit të Mbrojtjes Civile i FSK-së, në Pomozotin, është bërë me helikopter, i cili do të përdoret për qëllime të trajnimeve për kërkim-shpëtim. Prerjen e shiritit e kanë bërë komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri dhe drejtori i QTKSh-së, John Doone. Korniza e helikopterit do të përdoret në skenarë të ndryshëm për zhvillimin e disa trajnimeve, përfshirë këtu një aksident helikopteri me viktima brenda tij, një helikopter në ngritje me

viktima përbrenda, një helikopter në ulje me viktima në të dhe një ekip mjekësor të gatshëm për të ofruar ndihmë në rast nevoje, raporton "Epoka e re".

Shumë skenarë tashmë janë testuar gjatë trajnimeve të ndryshme të kërkim-shpëtimin, ndërkaq gjatë vitit 2019 do të fillojnë trajnime, në veçanti lidhur me helikopterë. E veçanta e këtij helikopteri është se i tëri sistemi është ndërtuar nga stafi i Qendrës së Trajnimit të Kërkim-Shpëtimin dhe është përdorur materiali i ricikluar i gjetur brenda kampit.

Korniza e helikopterit ka një gjatësi prej 23 metrash, me 3 metra gjerësi dhe me rreth 3



metra lartësi. Peshat totale e tij është diku rreth 12 tonë. Është i ngjyrosur me ngjyra kamuflazhi, me emblemë të Kryqit të Kuq në të dyja anët dhe ka përmasa dhe pamje të një helikopteri të vërtetë. Përbrenda ka dy ulëse për pilot, gjashtë ulëse me komplet pajisje për udhëtarë dhe gjashtë shtretër për viktima. Për qëllime trajnimi,

pjesës qendrore të helikopterit mund t'i vihet zjarri dhe sërish struktura e helikopterit do të mbetet e padëmtuar. E gjithë puna e planifikuar është kryer nga stafi dhe është mbështetur nga RMC-ja, gjatë kohës së trajnimeve të QT-së, në mbrëmje apo edhe gjatë fundjavave. Koha e paraparë për ndërtim ishte katër javë. Kostoja

materiale e gjithë projektit ishte 105 000 euro.

QT e RMC-së tani ofron një objekt trajnues që asnjë institucion tjetër trajnues vendor e ndërkombëtar në Kosovë nuk mund ta ofrojë. Gjithashtu, QT-ja do të ofrojë mundësi trajnuese të tjera në bashkëpunim me partnerët rajonalë dhe ata ndërkombëtarë.



Një vit burgim me kusht Ramadan Mujës

GJILAN, 19 DHJETOR (ER) - Gjykata Themelore në Gjiilan i ka shqiptuar dënim prej një viti burgim me kusht ish-kryetarit të Prizrenit, Ramadan Mujës, i cili akuzohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Përveç tij, fajtorë janë gjetur edhe zyrtarët M. K., A. A. dhe S. P.

M. K. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Administratës dhe A. A. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të kësaj komune kanë kryer veprën penale shpërdorim i pozitës ose autorizimit sipas nenit 422/1/2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Sipas njoftimit për media, i akuzuari Muja dhe S. P. për dispozitivin III të aktgjykimit janë shpallur fajtorë, pasi që R. M., në cilësinë e kryetarit të Komunës dhe S. P.,



në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, kanë kryer veprën penale shpërdorim i pozitës ose autorizimit sipas nenit 422/1/2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

(KPRK).

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe dëgjimit të dëshmitarëve, të akuzuarin R. M. për dispozitivin e aktgjykimit II dhe III i shqipton një dënim unik prej

një viti burgim, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari për periudhën e verifikimit prej dy vjetëve nuk kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën dënimin me kusht mund të revokohet.

Të akuzuarin M. K. për dispozitivin e II të aktgjykimit e dënon me kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve me kusht që brenda periudhës së verifikimit prej një viti të mos kryejë veprën tjetër penale. I akuzuari A. D. është shpallur fajtor për dispozitivin e II të aktgjykimit dhe gjykata ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej pesë muajve, me kusht që brenda periudhës së verifikimit prej një viti të mos kryejë veprën tjetër penale.

I akuzuari S. P. është shpallur fajtor për dispozitivin e III të

aktgjykimit dhe është dënuar në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh burgim, me kusht që brenda periudhës së verifikimit prej një viti të mos kryejë veprën tjetër penale.

Trupi gjykues të akuzuarin R. M. E ka liruar nga akuza për dispozitivin I të aktgjykimit për veprën penale shpërdorim i pozitës ose autorizimit në pajtim me nenin 422/1/2 të KPRK-së.

Ndërkohë për dispozitivin IV të aktgjykimit, veprën penale shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit sipas nenit 339/2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), gjykata ka refuzuar akuzën për të akuzuarin R. M., M. K. dhe A. T.

Palët kanë të drejtën e ankesës ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit.

Pacolli thotë se nuk ka tërheqje të njohjeve për Kosovën

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, gjatë raportimit të tij në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, ka thënë se nuk ka tërheqje të njohjeve për Kosovën ashtu siç kanë raportuar mediet serbe dhe politikanët e Serbisë. Ai ka thënë se procesi i dialogut Kosovë - Serbi po ndikon në perceptimet e shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka raportuar të mërkurën në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Ai gjatë këtij raportimi ka thënë se nuk ka tërheqje të njohjeve për Kosovën ashtu siç kanë raportuar mediet serbe dhe politikanët e Serbisë. Sipas tij, asnjë notë verbale për tërheqje të njohjes së shtetësisë së Kosovës, pos Ishujve Solomon, nuk ka ardhur në mënyrë zyrtare. Pacolli ka deklaruar se Kosova është e njohur me notë verbale nga 116 shtete të botës. Ministri Pacolli e ka pranuar se nuk ka qenë në disponim të marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit që opozita e kishte ftuar për të diskutuar lidhur me

dështimet e diplomacisë. "Isha nervoz. Nuk doja të më ofendonte dikush sepse nuk mund t'i pranoj ofendimet", është shprehur Pacolli.

Ai ka treguar se mungesa e tij në raportim në këtë komision ka qenë për arsye të vizitave zyrtare jashtë vendit. Ai ka thënë se nuk ka ikur nga raportimet e as nga përgjegjësitë që i ka si ministër. Pacolli ka theksuar para anëtarëve të këtij komisioni se, duke qenë ministër i një vendi që nuk është pjesë e OKB-së, detyrohet të vrapojë e të realizojë takime kudo që i jepet mundësia, pa përfshirë edhe korridoret. Sipas Pacollit, takimet e realizuara korridoreve të ndërtesës së Kombeve të Bashkuara nuk duhet të quhen si takime të realizuara nëpër "skuta". Pacolli ka deklaruar se procesi i dialogut Kosovë - Serbi po ndikon në perceptimet e



shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës. "Dialogu dhe vetë alarmi i shpërndarë nëpër botë për dialogun ka ndikuar edhe te njohjet. Serbët taktikisht po e fuqizojnë Rezolutën 1244. Ky është narrativi i krijuar nga serbët. Ne kemi marrë çdo masë që t'u tregojmë shteteve se nuk është kështu", është shprehur Pacolli. Ai ka folur edhe për

dështimin e Kosovës në Interpol. "Është bërë punë e madhe për Interpol, por unë asnjëherë nuk kam thënë se ne do të jemi anëtarë të Interpolit", ka deklaruar ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, para anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës.

Kryetarja e Komisionit, Vjosa Osmani, e ka kundërshtuar

ministrin Pacolli duke i bërë të qartë atij se ky komision i ka dërguar ftesë më shumë se gjashtë herë. Osmani ka kritikuar punën e dikasterit që e udhëheq Pacolli duke iu referuar mostransparencës që kjo ministri e ka me komisionin parlamentar. Ajo ka theksuar se shpreson që sugjerimet e dala nga ky komision të merren parasysh, sidomos në vitin 2019.

Kurti: Integrimi evropian është drejtuar në një rrugë të gabuar

EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Anëtarë të Komisionit për Integrim, deputetë të Kuvendit të Kosovës, njohës të çështjeve të integritetit dhe përfaqësues të shoqërisë civile, kanë organizuar të mërkurën tryezën "Raporti i Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian - lëvizja e lirë, reformat, MSA". Me këtë rast kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se ekipi negociator i formuar kohët e fundit po ndihmon rreth forcimit të imunitetit të presidentit Thaçi drejt pazareve me Serbinë. "Besoj se nuk mund të ketë integritet evropian pa integritet vetjak dhe se viti 2018 ka qenë vit i mungesës së integritetit në institucionet tona shtetërore. Nuk kemi pasur asnjëherë ndonjë qeveri me kaq shumë skandale sikurse kjo në vitin 2018 dhe, njëkohësisht, nuk kemi pasur asnjëherë politikë të jashtme më kaotike në Kosovën e pas shpalljes së pavarësisë

sikurse sivjet. Në përgjithësi kam përshtypjen se integrimi evropian është kërkuar në rrugë të gabuar, në rrugën e cila i shoqëronte servilitetin e politikanëve vendës ndaj zyrtarëve evropianë dhe dialogun pa kushte dhe pa parime me Serbinë", ka thënë Kurti, duke shtuar se raportet e Kosovës me Bashkimin Evropian kurrë s'kanë qenë në nivel më të ulët sesa tani. "Imazhi i Kosovës në Bashkimin Evropian kurrë s'ka qenë më i dobët sesa tani. Këtu, për mendimin tim, nuk ka të pafajshëm, por nuk duhet të përgjithësohet faji. Nuk e ka krejt Kosova fajin, nuk e ka fajin populli i Kosovës por, para së gjithash, qeveria aktuale, e cila është bërë pjesëmarrëse në kapjen e shtetit dhe ka mirëmbajtur pushtetin, i cili është më shumë regjim jodemokratik sesa qeverisje e mirë. Pra, nuk mund të thuhet se Kosova e ka fajin. Duhet të shohim se kush në Kosovë e ka fajin. Qeveria shpesh përpiket që ta shpërndajë fajin, ta përgjithësojë atë, në mënyrë që të shfajësohet për



vete", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se kryeministri i Kosovës ka rënë në kurthin e presidentit. "Meqenëse ai ka votuar, ka miratuar dhe mbështetur pa

rezervë, një grup negociator, i cili tash nëpërmjet znj. Mogherini, po bëhet ashtu siç e kemi parashikuar. Pra, një grup negociator, i cili shndërrohet në

mbështetje dhe imunitet për presidentin. Edhe mbështetje, edhe imunitet për presidentin, në kuadër të pazareve të tij me Serbinë", ka thënë Kurti.

Prodhimi vendor nuk mjafton, nevojiten kapacitete të reja në sektorin e energjisë

PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike për sektorin privat është kyç në veprimtarinë e bizneseve. Mungesa e prodhimit të mjaftueshëm në këtë sektor reflekton në joqendrueshmëri të furnizimit e që pastaj rezultojnë në humbje të shumta për bizneset. Kështu u tha të mërkurën në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ku u diskutua mbi çështjen e situatës aktuale të furnizimit me energji elektrike në vend. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka njoftuar të pranishmit me gjendjen aktuale në vend në aspekt të furnizimit me energji elektrike. Ai ka thënë se ministria që ai drejton angazhohet vazhdimisht që t'u përshtatet kërkesave të tregut duke siguruar kështu furnizim stabil të energjisë për bizneset dhe për qytetarët. Ministri Lluka ka shtuar se ndërprerjet e energjisë të cilat zakonisht bëhen janë kryesisht nga mbingarkesa dhe punimet e kohëpaskohshme në rrjetin elektrik dhe se nuk ka reduktime për



arsye të mungesës së prodhimit sepse energjia e munguar po sigurohet nga importi. Lluka ka thënë se për shkak të arsyeve politike, për mospërbushje të marrëveshjeve me Serbinë, nuk ka mundur të futet në funksion linja e interkoneksionit me Shqipërinë, që ka vonuar investimet e planifikuara të KOSTT.

Petrit Pepaj, drejtor menaxhues i Zyrës së Rregullatorit për Energji, ka thënë se ky institucion që na viti 2015 deri më tani ka lehtësuar çështjen e furnizimit të energjisë për bizneset duke iu ofruar zbritje prej 15 përqindësh. Ai ka përmendur nivelin jostabil të energjisë kohët e fundit si pasojë e mungesës së qën-

drueshmërisë së termocentraleve, duke theksuar mungesën e kapaciteteve të reja në këtë sektor si pengesën kryesore në zhvillim të saj. Pepaj ka thënë se konsumatori është prioriteti kryesor i ZRRE e cila është duke punuar për monitorimin e furnizimit të qëndrueshëm të energjisë elektrike

në mënyrë që të shmangin ndërprerje të panevojshme të energjisë.

Më tutje, bizneset e pranishme patën rastin t'i adresojnë shqetësimet dhe sfidat kryesore që po hasin në këtë aspekt duke u bërë thirrje institucioneve relevante për gatishmëri në këtë drejtim.

Certifikohen 25 kompani për bujqësinë organike



PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - Për grumbullimin e bimëve mjekësore, aromatike dhe pemët e imëta janë certifikuar edhe 25 kompani të cilat operojnë në gjithë vendin.

Certifikimi i këtyre kompanive me "Certifikata organike" është bërë të mërkurën nga Shoqata "Organika" dhe është mbështetur nga projekti "Promovimi i punësimit në sektorin privat" të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që implementohet nga "Swisscontact". Gjatë kësaj ceremonie, zëvendësministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka vlerësuar se ky proces i certifikimit të këtyre kompanive përbën një hap të rëndësishëm për përbushjen e objektivave të përbashkëta për zhvillimin dhe avancimin e sek-

torit të bujqësisë organike. Ai ka treguar se MBPZHR-ja përmes pagesave prej 500 eurosh për hektar mbështet sipërfaqet e kultivuara me produkte organike. Sipas statistikave në vitin 2017 në gjithë territorin e Kosovës kanë qenë 170 hektarë të kultivuara me bimë mjekësore aromatike, si dhe mbi 373 000 hektarë zona të certifikuar për grumbullimin e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe frutave të egra. Nga sot llogaritet se janë mbi 40 kompani dhe qendra të certifikuar, si dhe mbi 3 200 grumbullues në vend janë duke siguruar të ardhurat nga mbledhja e bimëve mjekësore aromatike, si dhe fruta të egra dhe kërpudha. Llogaritet se eksporti i këtyre produkteve bëhet gjysmë i përpunuar, ku 95 për qind e gjithë prodhimit të këtij sektori shkon për eksport, në Gjermani, Austri, Zvicër etj.

Dogana konfiskon duhan pa banderola dhe arreston një person të dyshimtë

HANI I ELEZIT, 19 DHJETOR (ER) - Dogana e Kosovës ka konfiskuar sasi të konsiderueshme të duhanit të kontrabanduar në rajonin e Ferizajt. Oficerët doganorë, pas një pune operative, kanë arritur të identifikojnë dhe lokalizojnë një automjet të dyshimtë për kontra-

bandë të mallrave. Pas lokalizimit të automjetit është bërë ndalimi i tij. "Pas hapjes së furgonit është vërejtur sasi e konsiderueshme e cigareve 'Bond', rreth 100 paketa, të cilat kishin vetëm banderolë të Republikës së Maqedonisë, që nënkupton mallra të kontra-

banduara. Pas numërimit të mallit është konstatuar se në furgon gjenden cigare pa banderolë të Kosovës. Malli dhe furgoni janë ndaluar derisa me urdhër të prokurorit personi që drejtonte automjetin është arrestuar", është bërë me dije në njoftimin e Doganës.



Shala: Vendimet që i kemi marrë dëshmojnë se po e mbrojmë konsumatorin

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka theksuar se që nga marrja e detyrës, mbrojtjen e konsumatorit e ka vendosur ndër prioritetet kryesore dhe, sipas tij, kjo është dëshmuar me vendimet që i ka marrë kjo ministri. Ai ka thënë se urdhëresa për ndalimin e shitjes së duhanit dhe alkoolit për moshën nën 18 vjeç është në vazhden e prioritetëve për mbrojtjen e konsumatorit. "Kontrolli i peshës së bukës dhe deklaracionit që kemi bërë nëpër subjekte ekonomike dëshmon se konsumatori ynë është i mbrojtur. MTI-ja ka ndaluar edhe lodrat që kanë rezultuar që janë të rrezikshme për shëndetin e fëmijëve. Ne po punojmë çdo ditë që ta mbrojmë konsumatorin tonë, t'i rrimë afër dhe ta kontrollojmë cilësinë e produkteve në treg dhe tregun në përgjithësi", ka thënë Shala në tryezën që është mbajtur për "Programin për mbrojtjen e konsumatorëve, të arriturat e vitit 2018, si dhe cilësia e produkteve vendore".

Ministri Shala ka bërë me dije se është shumë i rëndësishëm respektimi i së drejtës së konsumatorit dhe se kjo më së miri arrihet kur ligjet e Kosovës janë në përputhshmëri të plotë me direktivat e BE-së, që është edhe Ligji për mbrojtjen e konsumatorit i aprovuar këtë vit. Ai ka thënë se dëshirojnë një mbrojtje të drejtë, të plotë, gjithëpërf-

shirëse dhe adekuate të të drejtave të konsumatorëve, duke iu referuar sferës së shkëmbimit të të mirave materiale. "Po ashtu, në relacion me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, respektivisht shkaqeve, ndikimeve, veprimeve mashtruese, të cilat në përditshmërinë tonë si konsumator kanë potencial të rrezikojnë dhe dëmtojnë jetën, shëndetin, ambientin dhe familjet tona. Po ashtu, e rëndësishme së veçantë për vendin është mbështetja e prodhimeve vendore që cilësia e tyre të jetë konkurruese jo vetëm në tregun tonë, por edhe në tregjet ndërkombëtare", ka thënë Shala. Ministri Shala ka theksuar se angazhimi i MTI-së si autoritet kompetent për avancimin e pozitës dhe të drejtave të konsumatorëve, përveçse paraqet domosdoshmëri personale dhe njerëzore, është obligim ligjor dhe institucional për avancimin e proceseve të zhvillimit. "MTI-ja është zotuar të vazhdojë ta përmirësojë pozitën e konsumatorit përmes hartimit të legjislacionit sekondar si dhe ngritjes së bashkëpunimit me të gjitha organet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit për një ambient sa më të përshtatshëm për të gjithë në sikurse parashihet edhe në Programin për Mbrojtjen e Konsumatorit. Ne kemi bërë zgjerimin e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Ky Këshill tani është gjithëpërfshirës nga të gjitha institucionet të cilat merren me mbrojtjen e konsumatorit", është shprehur



Shala. Më tutje, ai ka përmendur faktin se fokus i tij do të vazhdojë të mbetet mbrojtja e konsumatorit në raport me cilësinë e produkteve. Ndërsa kryeshefi i Inspektoratit të MTI-së, Lulzim Sylja, ka thënë se gjatë 2018 kanë marrë një varg aktivitete, duke përmendur punën e inspektoratit në mbrojtje të konsumatorit. "Janë realizuar mbi 1 400

inspektime tek operatorët ekonomikë në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Janë marrë mbi 440 mostra të produkteve të naftës dhe është me rëndësi të theksohet se janë asgjësuar 17 mijë lodra, pasi kanë rezultuar se janë të rrezikshme pas analizave që janë bërë dhe janë kthyer mbi 20 importe në vend të origjinës pasi nuk i kanë plotësuar kriteret. Me këtë nënkuptojmë se është

rritur besimi në institucionin e MTI-së. Jemi duke i zbatuar të gjitha urdhëresat që i ka dhënë ministri Shala", ka thënë Sylja. Në anën tjetër, udhëheqësi i Departamentit të Konsumatorit në MTI, Nijazi Shala, ka thënë se janë shtypur dhe shpërndarë mbi 10 mijë fletëpalosje për informimin e konsumatorit dhe 1 000 fletëpalosje në gjuhën angleze dhe serbo-kroate.

Mbahet dëgjimi publik për Ligjin e Inspektoratit të Punës



PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - Zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Çerkin Dukolli, mori pjesë në tryezën e organizuar nga KDI-ja, për projektligjin e Inspektoratit të Punës. Me këtë rast në këtë tryezë u prezantua edhe hulumtimi parlamentar i përgatitur nga Komisioni për Shëndetësi,

Punë dhe Mirëqenie Sociale nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë tryezë merrnin pjesë deputetët nga Kuvendi i Kosovës, MPMS, sindikatat, anëtarë të shumtë nga shoqëria civile dhe media. Zëvendësministri Dukolli ka falënderuar grupin punues të MPMS-së, kryesuesen e Komisionit Funkcional të

Kuvendit, Besa Baftiu, deputetin Bekim Haxhiu, sindikatat, si dhe shoqërinë civile për kontributin e dhënë në hartimin e këtij dokumenti. Dukolli ka potencuar se qëllimi i hartimit të këtij projektligji është reformimi i institucionit të Inspektoratit të Punës sipas standardeve ndërkombëtare të ILO-s dhe

praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian. "Përmes këtij projektligji synojmë ta fuqizojmë dhe reformojmë Inspektoratin e Punës, i cili mandat kryesor ka mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së legjislacionit dhe akteve të tjera të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës dhe sigurisë e

shëndetit në punë", ka thënë ai. Dukolli ka thënë se do të bashkëpunojnë ngushtë me komisionin parlamentar funksional edhe në këtë fazë ku ndodhet projektligji, në mënyrë që në fund të ketë një ligj i cili do të jetë funksional dhe i zbatueshëm për të gjitha çështjet që i trajton.

Zvarritet procesi i zgjedhjes së përfaqësuesve të fshatrave në Ferizaj

FERIZAJ, 19 DHJETOR (ER) - Kuvendi Komunal i Ferizajt prej dy vjetësh kishte marrë vendim për ndryshimin e rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe zona urbane. Ndërkohë gjatë këtij viti komuna ka marrë vendimin për shpalljen e këtyre zgjedhjeve, mirëpo ky proces prej disa muajsh po zvarritet pa ndonjë arsye konkrete. Përfaqësuesit e disa fshatrave kanë thënë se komuna insiston ta politizojë procesin zgjedhor me qëllim që militantët e qeverisjes lokale (PDK) të zgjedhën

kryetarë fshatrash. Në këtë proces Komuna e Ferizajt është treguar jotransparente edhe me OJQ "INPO", e cila ka shprehur interesim për monitorimin e zgjedhjeve, mirëpo asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje. Arbenita Topalli, monitoruese në "INPO", ka thënë se komuna si njësi vetëqeverisëse, duke u mbështetur në rregulloren për bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe zonat urbane ka kompetencë t'i organizojë zgjedhjet e përfaqësuesve të bashkësive lokale, mirëpo procesi po zvarritet.



Komuna e Prizrenit ndihmon sipërmarrësit e rinj

PRIZREN, 19 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka bërë me dije se kanë bërë shpërndarjen e pajisjeve të punës për sipërmarrësit e rinj të cilët kanë pasur ide të mira, por nuk kishin kapital të mjaftueshëm për ta filluar biznesin e tyre. Ai ka thënë se me këto pajisje ata kanë filluar bizneset e tyre dhe do të kontribuojnë në ekonominë e

Kosovës. "Prizreni edhe më herët ka pasur një traditë të ndërmarrësisë, por ajo kryesisht ka qenë e bazuar në tregti. Krijimi i një mjedisi për ide dhe iniciativa të reja i ka motivuar këta persona që sot të jenë përfutues për të ndërmarrë diçka në lëmin e biznesit duke participuar me 20 për qind të shumës. Projekti u realizua nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit

Ekonomik në bashkëpunim me AZHR-Jug. Me këtë projekt janë krijuar biznese të reja nga ndërmarrës të cilët nuk kanë pasur kapital të mjaftueshëm për t'i filluar bizneset e tyre. Zhvillimi i ndërmarrësisë në nivelin e ekonomisë lokale ofron shumë mundësi punësimi dhe kjo mund të ndihmojë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë dhe në përbalimin e sfidave", ka thënë Haskuka.



Komuna e Kaçanikut pajis kompaninë 'Pastërtia' me 2 300 kontejnerë

KAÇANIK, 19 DHJETOR (ER) - Në kuadër të implementimit të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, Komuna e Kaçanikut ka pajisur Kompaninë "Pastërtia" me 2 300 kontejnerë me nga 120 litra. Nën kryetari i kësaj komune, Ylber Bajra, ka vizituar kompaninë "Pastërtia" dhe ka parë nga afër procesin furnizimit me kontejnerë, ndërsa e ka vlerë-

suar këtë aktivitet të rëndësishëm për forcimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave. Ndërsa drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Ramadush Osmani, ka thënë se edhe ky projekt është duke u realizuar në kuadër të përbushjes së objektivave të dala nga plani lokal për menaxhimin e mbeturinave, ku është paraparë që deri në vitin 2018 të

shpërndahen 3 000 copë shporta nga 120 litra. Ai ka bërë me dije se do të vazhdohet edhe gjatë vitit të ardhshëm për shtim të kapaciteteve në këtë kompani, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të një ambienti të pastër për të gjithë. Projekti në tërësi ka kushtuar 40 250 euro, që është financuar në tërësi nga buxheti komunal.

Hapësira e Komunës së Malishevës për një muaj do të jetë në shërbim të mërgimtarëve

Malishevë, 18 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, duke u bazuar në kompetencat e tij, ka marrë vendim që hapësira para objektit të kësaj komune për një muaj të jetë në shërbim të mërgimtarëve për parkimin e veturave të tyre të cilët vijnë për të marrë shërbime në komunë. "Nga sot deri më 15

janar të vitit 2019 oborri i objektit të administratës së Komunës së Malishevës do të jetë vetëm në shërbim të mërgimtarëve për parkimin e veturave dhe përjashtuar veturat zyrtare, nuk do të lejohet asnjë veturë tjetër që të parkohet në oborrin e komunës", ka njoftuar Komuna e Malishevës.



Injorancë apo lajthitje në Këshillin e Sigurimit ose përkujtues për disa anëtarë në KS



Nga Jakup KRASNIQI

Për zhvillimet e mbledhjes së 17 dhjetorit 2018 të Këshillit të Sigurimit (KS), të thirrur nga Serbia e Rusia për ushtrinë e Kosovës, nuk ka si të mos shtrohet pyetja: a kishin të drejtë disa nga folësit që t'i referoheshin Rezolutës 1244 të KS apo ta ndryshonin atë Rezolutë? Që të dyja përpjekjet janë absurde! Rezoluta i përket historisë, pasi proceset kanë avancuar aq shumë, duke filluar me Kornizën Kushtetuese, e cila ka hyrë në fuqi më 15 maj 2001. Korniza Kushtetuese është nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), Hans Haekkerup, në bazë të kompetencave që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të 10 qershorit 1999.

Zhvillimet e tjera do të shpjegohen në vazhdim.

Diskutuesit a ishin në dijeni se cilës rezolutë i referoheshin dhe a ekziston shteti që i referohet Rezoluta 1244 e KS?

Fillimisht duhet ta shohim se çka thotë vetë rezoluta në fjalë. Pika 3 e Rezolutës 1244 thotë: "Këshilli i Sigurimit kërkon në veçanti që RFJ t'i japë fund menjëherë dhe në mënyrë të verifikueshme dhunës dhe represionit në Kosovë, dhe të fillojë tërheqjen e plotë dhe të verifikueshme sipas fazave të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare në bazë të një orari të caktuar me të cilin do të sinkronizohet vendosja e pranisë ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë".

Siç shihet qartë, Rezoluta i referohet një shteti (RFJ-së) që nuk ekziston më. Pra, RFJ është shpërbërë në shtatë shtete. Të fundit që janë divorcuar nga RFJ-ja janë: Serbia, Mali i Zi dhe Kosova. Kjo e fundit është divorcuar me luftë të armatosur, e ndihmuar edhe nga ndërhyrja ndërkombëtare. Kosova rrugën e vet të pavarur e ka filluar me Rezolutën 1244 të KS të miratuar më 10 qershor 1999 dhe e ka

përfunduar më 17 shkurt 2008, ndërkombëtarisht të vulosur në korrik të vitit 2010 nga GJND-ja. Kësaj rruge i kanë ndihmuar edhe dy emisarët e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. I pari ishte Kai Aides dhe Raporti i tij (Nju Jork, 13 qershor 2005), i cili konstatonte se "Bashkësia ndërkombëtare nuk mund të jetojë me një politikë që është perceptuar si politikë e status-quo-së" (pika 10 e Raportit). Kjo do të thoshte se status quo-ja në Kosovë nuk mund të vazhdonte më. Në pikën e 70 të Raportit Kai Aides në mes të tjerave shkruan: "kur të ketë filluar procesi, ai nuk mund të bllokohet dhe duhet të çohet në fund". Pas kësaj, sekretari i përgjithshëm i OKB-së cakton emisarin e tij të dytë më 2 nëntor 2005. Këshilli i Sigurimit konfirmoi zyrtarisht emërimin e ish-kryetarit finlandez Marti Ahtisari, si të dërguar të posaçëm të OKB-së në negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës për zhvillimet e bisedimeve të Vjenës. Bisedimeve të Vjenës i ka paraprirë edhe Deklarata e Grupit të Kontaktit, pjesë e të cilit ishte edhe Rusia. Në pikën 6 të Deklaratës së 31 janarit 2006 thuhet: "Zgjedhja e statusit të Kosovës duhet të konsolidojë sigurinë e stabilitetin në rajon...". Garanci për të ndodhur kjo deklarata nënvizon: "Kosova të mos kthehet në gjendjen e para marsit 1999... nuk do të ketë ndryshim të territorit dhe as do të ketë ndarje dhe as bashkim me ndonjë shtet tjetër apo me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër". Bisedimet e Vjenës vazhduan në vitin 2006 dhe përfunduan në vitin 2007 me një Dokument për Zgjidhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës, të njohur edhe si Dokumenti i Ahtisarit. Ahtisari pas përfundimit të bisedimeve i shkruan sekretarit të përgjithshëm dhe presidentit të KS-së një letër propozuese ku në mes të tjerave i thotë: "Duke marrë me kujdes në konsideratë historinë e kohëve të fundit në Kosovë, realitetin e Kosovës sot dhe duke marrë parasysh negociatat me palët, unë kam ardhur në përfundim se i vetmi opsion i qëndrueshëm për Kosovën është pavarësia e mbikëqyrur për një periudhë fillestare nga bashkësia ndërkombëtare". Ndërsa në përmbledhjen ekzekutive të dokumentit të tij Ahtisari shkruan: "Kosova do të

jetë një shoqëri shumetnike, që e qeveris veten në mënyrë demokratike...".

Pas gjithë këtyre akteve ndërkombëtare, Kosova në bashkërendim me faktorin ndërkombëtar më 17 shkurt 2008 e shpall Pavarësinë. Në Deklaratën e Pavarësisë në pikën 1 është nënvizuar: "Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet të kësaj Deklarate e shpallim Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik...". Ky është rrugëtimi i Pavarësisë së Kosovës me një bashkëpunim e bashkërendim me Bashkësinë Ndërkombëtare, me OKB-në, Këshillin e Sigurimit, Grupin e Kontaktit, SHBA-të dhe BE-në. Ndërsa, Kushtetuta e Kosovës e hartuar me ekspertët amerikanë e britanikë, në nenin e saj të parë shkruan: "Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm". Ndërsa në nenin 2 paragrafi 1 shkruan: "Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

Duke u nisur nga të gjithë dokumentet e lartcekura Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, më 22 korrik 2010, kishte ardhur në përfundim se: "Në normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare nuk konstatohet asnjë ndalim, konkret (applicable prohibition) për deklarimin e pavarësisë", prandaj "Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit 2008 nuk cenon të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare".

A ka diçka më të qartë se kaq. Veç kësaj, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në dhjetor të të njëjtit vit ka nxjerrë një Rezolutë e cila kërkon që Serbia e Kosovës të zhvillojnë bisedime teknike me mbikëqyrjen e Brukselit (BE-së). Pra në gjithë procesin, filluar nga 9 qershori i vitit 1999 e krejt deri të shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 dhe Vendimi i GJND-së dhe Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e dhjetorit 2010. Pra i gjithë ky proces ka kaluar nëpër organet më vitale të OKB-së. Parlamenti Evropian, institucioni përfaqësues i popujve të

shteteve që e përbejnë Bashkimin Evropian, pavarësinë e Kosovës e ka njohur që në vitin 2008.

Pas gjithë këtyre zhvillimeve, përsëri në bashkërendim me Komunitetin Ndërkombëtar më 22 shtator 2012, Shtetit të Pavarur dhe Sovran të Kosovës i hiqet Mbikëqyrja e Pavarësisë. Botërisht dihet se Pieter Feith i kishte dy kapela, njëra ishte OKB-ja dhe tjetra BE-ja. Pas gjithë këtyre argumenteve shtrohet pyetja: Në mbledhjen e 17 dhjetorit 2018 të Këshillit të Sigurimit në Nju Jork disa anëtarë të KS ishin injorantë apo të lajthitur?! Ata do të duhej ta kishin të njohur se Rezoluta 1244 është historike dhe si e tillë, as nuk mund dikush t'i referohet e as të ndryshohet, madje edhe shteti që i referohet Rezoluta në fjalë nuk ekziston më. Madje, a ka absurd më të madh fakti se si është e mundur që edhe pas dhjetë viteve të pavarësisë së Kosovës, Këshilli i Sigurimit të mos e dijë rolin e UNMIK-ut në Kosovë?! Mëkat për njerëzimin, kush po flet e nga kush pret sigurinë globale! E gjithë kjo që u tha e bën krejt të panevojshme, madje edhe absurde, mbledhjen e 17 dhjetorit 2018 të Këshillit të Sigurimit për rrezikun e botës nga 5000 pjesëtarët e Ushtrisë së Kosovës!

Meqë absurdet nuk kanë të sosur, ja edhe absurdi i radhës: disa anëtarëve të KS si nuk iu vjen keq për politikën e kriminit e të gjenocidit serb në Kosovë, por e shohin rrezikun nga ushtria e një populli të Kosovës, që nuk e arrin as numrin prej dy milionë banorësh?!

Është për t'u habitur se si vendet e mëdha si Rusia e Kina në KS kanë përfaqësues kaq të paarsimuar që mund të quhen pa hezitim analfabetë potencialë.

Është keq, vërtet keq, që një organ i lartë i OKB-së, siç është Këshilli i Sigurimit, në vend se ta ndihmojë sigurinë planetare, ai e bën të kundërtën! Kështu, KS një mizë e bëri jo buall, por sa Malet e Himalajeve!

Sa herë janë çoroditur drejtues të kombeve të mëdha, njerëzimi ka përjetuar rreziqe në shkallë botërore, e sidomos kanë pësuar popujt numerikisht të vegjël siç është rasti me shqiptarët.

Prishtinë, 19 dhjetor 2018

A mund të pajtohet Kosova me Serbinë, me letra dhe kërcënime?!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Lobistët e Serbisë, Frederika Mogerini dhe Johannes Han: Nëse dikush e ka dëmtuar shumë Kosovën dhe qytetarët e saj vitet e fundit atëherë nuk ka dyshim se ata janë lobistët e fshehur të Serbisë tani dhe, sigurisht, lobistë të ardhshëm të këtij shteti armiqësorë, Johannes Han dhe Frederika Mogerini.

Përveçse e kanë dëmtuar riparueshëm Kosovën po këta dy burokratë të BE-së dhe aktivistë të Serbisë, skajshmërisht i kanë dhunuar shpresat dhe ardhmërinë e Kosovës. Nëse dikush ua ka shkelur të drejtat e njeriut qytetarëve të Kosovës duke i futur në kafaz dhe rrugë qorre, pa mundësi të daljes, atëherë ky është dyshi famëkeq racist, Frederika Mogerini dhe Johannes Han. Nëse dikush ka gënjer dhe mashtruar qytetarët e Kosovës të cilët i ka keqpërdorur duke i bërë favore Serbisë atëherë është dyshi i kusarëve burokratë të Brukselit, Frederika Mogerini dhe Johannes Han. Nëse dikush ka injoruar qytetarët e Kosovës duke dhunuar të gjitha institucionet, përjashtuar këtu Shkëlqesinë e Tij, presidentin tarak Hashim Thaçin, atëherë është dyshi mafioz i BE-së, Frederika Mogerini dhe Johannes Han. Nëse dikush ka bërë dhe po bën përpjekje ta rikthejë dhe fuqizojë potencën politike të hamshorit të tredhur atëherë janë viatrat, buzë afatit të skadencës e që pas katër muajve nuk mund të shërbejnë as si paracetamol, Frederika Mogerini dhe Johannes Han. Nëse dikush e meriton përbuzjen e qytetarëve të Kosovës për injorancën e shfrenuar dhe dëmin që ua kanë bërë dhe po e bëjnë, atëherë këta janë kameleonët Frederika Mogerini dhe Johannes Han, kajmani president, me tredharakët dhe profiterët që i lëvyrën, e që janë të privuar nga çdo skrupull moral dhe ndjenjë e përgjegjësisë. Nëse sekserja Frederika Mogerini botërisht thotë se nuk ka kush tjetër që të flasë për Kosovën përveç Hashim Thaçit atëherë, të gjithë të përbashkuar duhet ta veshim Hashimin me tëlina të mëndafshit dhe t'ia fusim Frederikës në shtat, pasi nuk ka të tjerë. Bizantinët Frederika Mogerini dhe Johannes Han e kundërshtuan Ushtrinë e Kosovës, po e kundërshtojnë taksën prej 100

përqindësh për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e demokratit Dodik, vëllamë i Orbanit, Sheshelit dhe Gruevskit dhe këtë e bëjnë sepse po u varfërohet grazhdi që kohët e fundit aq shumë po e frekuentojnë, atë të Serbisë të cilin, ciniku, mashtruesi dhe gënjeshtari Han deshi ta fisnikërojë me para të imëta, apo para xhepi për Serbinë, 97 milionë euro sa për fillim. Të korruptuarit pastaj mbajnë ligjërata se si duhet të luftohet korrupsioni, nëse doni liberalizim të vizave. Gijotinistët burokratë të BE-së, robespjerët e demokratizuar Frederika Mogerini dhe Johannes Han, duan kokën e Ramush Haradinajt vetëm se nuk po mendon dhe nuk po flet sikur presidenti legjendar, kukull e dyshes raciste. Një popull i vetëdijësuar kombëtarisht dhe politikisht, pas ndërhyrjes së ndyrë të Frederika Mogerinit dhe Johannes Han në punët e Kosovës, masivisht do të dilte në rrugë në kundërshtim të këtyre kusarëve dhe kukullave të tyre dhe në përkrahje të kryeministrit dhe të tjerëve që kanë bol... dhe jo impiante silikonit që nuk mund ta bëjnë punën e bol...! Vafshi në vilën e Dante Aligerit të quajtur ferr, ju maskarenj të tragjedisë njerëzore, ju, belzebubë të tiranisë, të maskuar në kerubinë të demokracisë dhe, si vlerë të shtuar marrshi me vete presidentin kukull, bashkë me një president, gjithashtu kukull, si nga sjellja ashtu edhe nga përmbajtja, që as nuk skuqen e as nuk zverdhën!

Trekëndëshi i Bermudeve apo letra e Trampit, Mogerinit dhe Gjykata Speciale: Më në fund është sqaruar fshehtësia e Trekëndëshit të Bermudeve ku, në rrethana misterioze, zhdukeshin anijet dhe fluturaket që fluturonin mbi ujë, në këtë pjesë të Oqeanit. Tash Trekëndëshi i Bermudeve nuk citohet si burim rreziku dhe tmerri për ata që kalojnë mbi të. Trekëndëshi përbëhet prej tre këndeve sikur që edhe trekëndëshi i ditëve tona përbëhet prej tre këndeve: Letrës së presidentit Tramp, letrës së burokrates Mogerini dhe Gjykatës Speciale me seli në Hagë (Gjykatë e Kosovës!!!!!!) për faktin se nuk kanë gjetur zyrë me qira në Kosovë. Në Beograd janë sistemuar shumë mirë. Letra e kusares Frederika Mogerini është kundër Kosovës, kundër institucioneve të Kosovës, hiç këtu presidentin legjendar dhe, në veçanti kundër Ramush Haradinjat. Letra e Frederika Mogerinit, racistes së demokratizuar, është akuzë, aktgjykim dhe vendim për ekzekutim me vdekje politike të kryeministrit të Kosovës e që po përkrahët nga kryeprokurori i Shtetit, Hashim Thaçi. Kjo letër i ka ard-

hur në kohën më të duhur, si dhu-ratë, Hashim Thaçit i cili, botërisht, nga nëntoka (jotransparenca) po e falënderon Frederika Mogerinin. Letra e Frederika Mogerinit e shkërdhenë ekipin negociator duke e shndërruar në grup që, kompetenca e vetme apo kryesore është mbajtja e qiriut për Hashim Thaçin gjatë orgjive politike dhe jopolitike. Kjo letër e shndërron Platformën për Negociata në një letër pa vlerë, madje as për letër tualeti. Kjo letër është në koordinim me letrën e nënshkruar nga presidenti Tramp, si kryegjykatës i botës. Frederika e do Hashim Thaçin deri në nënshkrim të marrëveshjes. Pastaj e hedhë, sikur të mos kishte ekzistuar kurrë. Hashim Thaçi është i pasionuar pas letrimit të letrave të Frederikës dhe Trampit, sidomos kur atë e vendosin si timonierin numër një dhe të pazëvendësueshëm. Dashuria bëhet edhe më e madhe kur e lexon edhe aneksin për pushkatim të Ramush Haradinajt. Letra e Mogerinit është kundërmuese, e ndyrë dhe kërcënuese. Ajo nuk pranon as gjurmë të moralit, ajo nuk pranon as edhe një gram kundërshtimi. Ajo është mësuar që përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet e Brukselit të mos e shohin në sy sikur që nuk ka pranuar as Gadafi gjatë ekskursionit historik të grupit të intelektualëve kosovarë, të udhëhequr nga patrioti dhe intelektual i Madh, Behgjet Pacolli, ta shohin në fytyrë derisa nuk i ka lejuar vetë ai. Frederika Mogerini ka urrejtje patologjike dhe është hakmarrëse ndaj atyre që ua tregojnë fytyrën dhe që kanë qëndrim ndërsa përkrahë pakurizorët dhe lëvyrësit. E vetmja vlerë njerëzore e Frederika Mogerinit dhe Johannes Hanit është dhembja e madhe ndaj serbëve dhe kompanive të Serbisë, të cilët, për shkak të vendosjes së taksës prej 100 përqindësh, po vdesin urie dhe janë në një krizë të thellë humanitare. Jetën mund t'ua shpëtojnë vetëm eurot dhe dollarët e kosovarëve të cilëve u shesin mall me afat të skaduar. Frederika dhe Johannes, shumë të brengosur, po këmbëngulin që Qeveria e Kosovës ta heqë taksën 100 për qind për mallrat serbe dhe ato të Dodigut, nëse duan vazhdimin e bisedimeve për të cilat Hashimi, thjesht po vdes! Letra e presidentit Tramp është artileri e rëndë, duket e papërballueshme. Ajo nuk është as sugjerim e as udhëzim, ajo është urdhër që duhet të ekzekutohet. Fillon me pajtimin e Kosovës me Serbinë e që kjo nënkupton se të gjitha kërkesat e Platformës për Negociata mund t'i lëshoni poshtë, me ujë. Nuk është ky pajtim në bazë të vullnetit të shprehur, por është pajtim nën dajak. Ky pajtim po e shkërdhen idenë

gjeniale të presidentit për formimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtim. Në vend të saj po formohet Komisioni për Gënjeshtër dhe Dhunim. Në këtë letër presidenti Tramp e citon presidentin tonë gjenial, Hashim win - winin i cili, që nga fillimi në parashikimet e Nostradamusit apo Komandant Kamishit deklaronte se në marrëveshjen detyruese, ligjore nuk do të ketë humbës, por të gjithë do të ndahen fitues e sidomos Serbia, sikur në Fermën e Kafshëve ku të gjithë janë të barabartë, por se kryedheri Napoleon është pak më i barabartë se të tjerët. Që të mos akuzohet për plagjiaturë, presidenti Tramp thotë se në këtë marrëveshje do të ketë ekuilibrim të interesave të Serbisë dhe Kosovës. Pastaj, presidenti Tramp thotë se të gjithë liderët e Kosovës duhet të flasin me një zë, kuptohet, me zërin e Hashimit. Është një kërcënim se, nëse nuk e shfrytëzojmë këtë rast unik për marrëveshje, atëherë do të ketë një prapaktim dhe rasti tjetër do të vonohet shumë. Në këtë rast përmendet investimi i madh amerikan në Kosovë e që nënkupton thënieën që e përdornin rusët pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kur shaloni gratë dhe femrat e vendeve që i kishin çliruar: "Ja te oslobodill, ja te jeball", "unë të kam çliruar, unë kam për të palluar".

Presidenti Tramp e bën një hajgare të madhe me ne dhe Kosovën kur thotë se Kosova është vendi kryesor për vendosjen dhe ruajtjen e paqes në Evropë. Dhe krejt në fund e caktton vendin dhe ceremoninë ku do të nënshkruhet marrëveshja historike, Shtëpia e Bardhë në Uashington, ku do t'i mirëpresë të dy presidentët të cilëve ua dërgon të njëjtën letër, sikur babai që ua dërgon një letër të njëjtë të dy bijve të vet të llastuar, por që kanë vendosur të pajtohen dhe të jetojnë si vëllezër. Dhe, në fund të letrës, presidenti Tramp, duke ditur se presidenti i Kosovës nuk hynë gjithkund dhe se ka standarde në çfarë lokacione pshurrë e lëre më të nënshkruajë marrëveshje historike, Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë ua ka lënë në dispozicion. Qysh tash, sinjor presidente bënë plane, si të vishet, a do të përdorë kollare Hermes, a do ta përdorë si kondom njërin nga përcjellësit e tij apo do ta marrë një të parfumosur çfarë brekushe do të vesh, këpucë, kostum Prada apo kostum H. Th. e detaje të tjera. Për disa minuta, tërë reflektorët e vëmendjes botërore do të drejtohen kah presidenti ynë. Ky është momenti i hyrjes në histori përmes histerisë. Pas tij do të shkëlqejë fytyra e presidentit tjetër të Kosovës të cilin e ka kontrabanduar si president Hashimi

duke e dhunuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që asnjëherë nuk e ka njohur për president këtë farë fakiri. Përfundimisht jam budalla. Po të kisha mend, edhe unë do të isha afër presidentit, me presidentin tjetër që e ka emrin tim. Po, shumica gojës ia kanë parë sherrin. Që nga kohët e lashta. Ciceroni, pasi u ekzekutua në mënyrën më mizore, gruaja e Mark Antonin, Fulvia, ia shpoi gjuhën me një spilë flokësh shkak se Ciceroni paska folur keq për burrin e saj, Mark Antonin. Mua, eventualisht mund të m'i thyejnë gishtërinjtë apo duart me të cilat shkruaj, pa pasur nevojë të më shpojnë gjuhën për faktin se nuk jam orator si Ciceroni. Nuk e besoj se këtë do ta bëjë Hashimi sepse është i njohur për humanizmin e tij, por ka mjaftueshëm banditë që mund të më trajtojnë sikur Kashogin. Të merremi me tema më të këndshme, mos të shohim vetëm zi, mos të ndihemi humbës dhe defetistë, të bëhemi optimistë kur të gjithë do të jemi Winwina.

Meqë është fundviti dhe duhet dërguar urime, edhe Gjykata Speciale nuk bën asnjë përjashtim; të gjithë atyre që nuk binden ua dërgon një kartolinë nga Haga, me nënshkrim të prokurorit sepse thonë se dallohet për bukurshkrim!

Behxhet, u kry puna: Luani, një mik imi dhe njeri shumë i kthjellët, kur biseduam për letrën e Trampit, puna e parë më pyeti nëse e flas apo e kuptoj gjuhën angleze. I thashë se e kuptoj, por jo aq mirë dhe rrjedhshëm sa presidenti ynë, Hashim Thaçi. Atëherë, Luani më tha se letra e Trampit, në fakt, është "game over" (nuk jam i sigurt se e kam shkruar korrekt) ose, meqë jemi miq, pa kompensim ma përktheu se: loja mbaroi, loja përfundoi apo se puna u kry. Duke e ditur nivelin tim të inteligjencës, Luani m'i dha tri mundësi për ta kuptuar gjendjen në të cilën gjende-mi. Pastaj foli në gjuhën e Erdoganit e që e përktheu disi, leja emrin femijës. Pajtohem plotësisht se jemi para aktit të kryer, prandaj i shoh si të tepërta ekipin negociator dhe platformën për negociata. Kësaj vetëm mund t'i shtoj një mendim timin (mendoj, prandaj ekzistoj, filozof i çartur jam!!!) se teshat na janë prerë për ta mbuluar lakuriqësinë e turpit anatomik dhe bol..., në rast se i kemi apo për ta mbuluar prapancën e dhunuar, më shumë me vullnetin tonë se që realisht na kanë dhunuar. Mirëpo, gjithashtu mendoj, prapë unë mendoj, se sa më shumë t'i veshim këto rroba, aq më tepër do ta lakuriqësojmë mjerimin tonë njerëzor, kombëtar, politik, kulturor dhe moral. Qofsha i gabuar!

Wanda Nara "shkëlqen" në festën e Krishtlindjes tek Interi



Bashkëshortja e Mauro Icardit është bashkuar me festën e Krishtlindjes, në klubin e Interit. E veshur me ngjyra zi dhe kaltër, Wanda Nara ka çuar një tjetër sinjal dashurie ndaj klubit të Interit,

ndërsa ka shkëlqyer gjatë festës në klubin milanez. Në ceremoninë e organizuar në Milano kanë qenë të gjithë futbollistët zikaltër, shumë prej të cilëve të shoqëruar nga partneret përkatëse.

Rita promovon albumin në Nju Jork



Të martën Rita Ora ka bërë promovimin e albumit të saj më të ri 'Phoenix' në Nju Jork. Mediat ndërkombëtare që kanë ndjekur nga afër këngëtarën me orgjinë shqiptare nuk lanë pa komentuar edhe veshjet e saj. Gjatë kësaj mbrëmjeje Rita ka

ndërruar pesë palë veshje, katër fustane dhe në fund një veshje sportive. Pa dyshim, paraqitja e Orës është vlerësuar pozitivisht nga mediat dhe nga fansat e saj që vazhdojnë ta mbështesin gjatë gjithë karrierës muzikore.



Dua Lipa, pjesë e filmit "Alita Battle Angel"

Këngëtarja me famë botërore, Dua Lipa, ka lajmëruar se kënga e saj e re do të jetë kolona zanore e filmit thriller/fanta shkencë "Alita Battle Angel". Në një postim në "Instagram" Dua ka

falënderuar të gjithë bashkëpunëtorët dhe ka bërë thirrje se të gjithë duhet ta shohin këtë film. Kënga do të ketë edhe një videoklip dhe filmi do të shfaqet në kinema më 14 shkurt 2019.

50 Cent dekoron pemën me këpucët e ish të dashurës




Të gjithë gjejnë mënyra nga më të veçantat për ta dekoruar pemën e Krishtlindjeve, por këtë vit me plot bindje ky çmim i jepet reperit të njohur 50 Cent. Ai ka ndarë me ndjekësit në "Instagram" pemën të dekoruar me këpucët e ish të dashurës. Në pemë janë varur shumë këpucë me takë dhe nën të kutitë e këpucëve që duket se janë të markës Christian Louboutin.



E jashtëzakonshme

Krijohet 'bomba' për t'i kapur hajdutët

Një ish-inxhinier i NASA-s kaloi gjashtë muaj për të ndërtuar një kurth i cili ngjan si bombë për t'i mashtruar hajdutët pasi disa parcela ishin vjedhur nga pragu i tij. Pajisja, e fshehur në një kuti Apple Homepod, që mbante katër celularë dhe një qark (453 g) të mbushur shkëlqim me kamerë brenda. Mark Rober, i cili tani është një i njohur në 'YouTube', i kapi hajdutët me anë të kamerës së sigurisë në



shtëpi. Ideja për ta krijuar bombën e rremë i erdhi pasi policia i tha se nuk ishte në gjendje ta hetonte rastin.

FOTO E DITES



Kjo hekurudhë që po shihni në foto ndodhet në Zvicër, panoramë mahnitëse në kohë dimri. /Glacier Express/

E rrallë

Pak para vdekjes, 87-vjeçari befason fqinjët me surprizën

Një familje u befason kur zbuloi se fqinji i tyre i moshuar para se të vdiste i kishte lënë vajzës së tyre

dyvjeçare dhurata Krishtlindjesh për 14 vjet. Ken Watson, i cili vdiq në moshën 87-vjeçare, jetoi afër familjes

së Owen dhe Caroline Williams në Barry, Vale of Glamorgan dhe ishte mjaft i lidhur me vajzën e tyre Cadi.



BARSOLETA E DITËS



E ndal polici njërin me veturë dhe e pyet:

- Çka ki prej pajisjeve dimërore?
- Vallahi veç një palë çorape të leshta!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.

Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.

Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.

Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.

Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



DASHI

Duhet të jeni krenar për veten sepse po


tentoni në të gjitha mënyrat të shpëtoni një raport që ka mjaft probleme që në fillim të tij.



DEMI

Gjatë ditës së sotme do të takoni shumë persona

të rinj dhe do të ndikoheni mjaft pozitivisht prej tyre. Këto njohje do t'ju ndihmojnë në të ardhmen.



BINJAKËT

Meqenëse keni marrë shumë

gjëra përsipër sot jeni mjaft në tension që t'u dilni zot të gjithave. Nëse nuk do të arrini në ndihmë do t'ju vijë familjarët.



GAFORRJA

Gjërat tuaja të vogla dhe personale

mbase nuk janë në interesin e të gjithëve dhe nuk keni pse i bëni shumë publike. Merruni me çështje më madhore.



LUANI

Do të hasni në mjaft

problematika sot gjatë ditës por, nëse nuk filloni t'i zgjidhni, do të mblidhen të gjitha në fund.



VIRGJËRESHA

Nëse jeni të interesuar për t'i shprehur

dashurinë personit që keni në krah ose dikujt që sapo e keni njohur, sot është dita ideale për ta bërë.



PESHORJA

Duhet të punoni shumë që rezultatet të

jenë ato që prisni në një projekt të caktuar. Duke qëndruar në pritje nuk do të arrini asgjë.



AKREPI

Nëse doni të ndiheni të lumtur këtë periudhë

duhet të jeni më i pranishëm me familjarët tuaj për t'i rivendosur dialogët e ndërprerë prej kohësh.



SHIGJETARI

Keni marrë vendime që kanë

ndikuar shumë në karrierën tuaj dhe do të ndikojnë në financat tuaja në të ardhmen.



BRICJAPI

Edhe pse po impenjoheni shumë të

dukeni karshi një personi të caktuar nuk do të bëjë ndonjë dallim të madh në jetën tuaj personale.



UJORI

Duhet t'u kushtoni më shumë vëmendje

veprimeve tuaja sepse sot dikush po ju vëzhgon nga lart dhe nuk do t'i pëlqejë një sjellje e juaja.



PESHQIT

Dita e sotme do të jetë impenjative

dhe duhet të bëni të pamundurën të mbyllni me sukses çdo iniciativë ose aktivitet që filloni.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FEYENOORD - UTRECHT

1

FC KOPENHAGEN - ODENSE

1

AALBORG - RANDERS

1

Dautaj: Ferizaj nuk ka frikë nga Feronikeli, synon gjysmëfinalen

Qëndrim Dautaj është optimist se skuadra e Ferizajt mund të shkëlqejë në garën e Kupës ani pse kundërshtar e ka Feronikelin. "Jemi të vetëdijshëm se do të jetë një ndeshje shumë e vështirë, por ne luajmë në fushën tonë dhe do të hyjmë për fitore. Shpresojmë të kualifikohemi në gjysmëfinale të Kupës, pse jo edhe në finale", ka thënë Dautaj për "Epokën e re"

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 DHJETOR - KF Ferizaj është kualifikuar në çerekfinale të Digitalb Kupës së Kosovës në futboll. Futbollisti Qëndrim Dautaj është shprehur i kënaqur me këtë sukses, por është i vetëdijshëm se skuadrën e tij e pret një punë shumë e vështirë ndaj Feronikelit. Pavarësisht që kundërshtari ka cilësi, Dautaj ka thënë se Ferizaj synon të kualifikohet fillimisht në gjysmëfinale, më pas edhe në finale të Kupës. "Ne i kemi fituar dy ndeshje, po kundërshtarët kanë qenë të rangut më të ulët. Tash e kemi ndeshjen me Feronikelin që është një skuadër me lojtarë shumë cilësorë dhe lufton për titull dhe Kupë, por ne nuk i frikësohemi. Jemi të vetëdijshëm se do të jetë një ndeshje shumë e vështirë, por ne luajmë në fushën tonë dhe do të hyjmë në këtë ndeshje për fitore. Shpresojmë të kualifikohemi në gjysmëfinale të Kupës, pse jo edhe në finale", ka thënë Dautaj për "Epokën e re".

Në kampionat skuadra e Ferizajt, pavarësisht prej paraqitjeve të mira, nuk ka regjistruar rezultate pozitive dhe sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e parafundit me 15 pikë, shtatë pikë më pak se skuadra e Trepçës '89 që është në pozitën e tetë. "Rezultatet në sezonin vjeshtor nuk kanë qenë aspak të kënaqshme, pasi dihet që jemi në vendin e parafundit në tabelë që na dërgon në Ligën e Parë. Potencial kemi pasur si skuadër, por



edhe paraqitje të mira, prandaj është dashur të kemi më shumë pikë të grumbulluara", ka deklaruar futbollisti Dautaj, duke shtuar: "Ferizaj ka nevojë për tri përforsime në afatin kalimtar të janarit për të qenë më të sigurt në garën për mbijetesë. Në tri repartet, mbrojtje, mesfushë dhe

sulm".

Qëndrim Dautaj ka luajtur për shumë skuadra në Kosovë, duke filluar nga Flamurtari, Llapi, Besa dhe Feronikeli. Ai ka kontratë me Ferizajn deri në qershor të vitit 2019, kurse në vitin 2014 ishte shpallur në mesin e dhjetë futbollistëve më të mirë në Kosovë.

SHKURT

Abrashi rikthehet në mars

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Amir Abrashi, i cili ka vuajtur nga një lëndim i gjatë, pritet të jetë i gatshëm për pjesën e dytë të kampionatit. Lajmi është konfirmuar nga trajneri i Freiburgut, Christian Streich. "Amiri po stërvitet shumë mirë dhe shumë fort. Të gjithë që e njohin Amirin e dinë se ai është një luftëtar i pabesueshëm në fushë dhe stërvitet gjithmonë mirë. Ai do ta nisë stërvitjen me skuadrën në fund të janarit dhe do të jetë i gatshëm në mars", ka thënë Abrashi.

Mourinho pas shkarkimit: Nuk kam çfarë të them

Jose Mourinho është shkarkuar të martën nga detyra e trajnerit të Manchester Unitedit. Gazetari i "Sky Sport" e ka pyetur trajnerin portugez rreth shkarkimit dhe të ardhmen, por ai është përgjigjur shumë shkurt: "Nuk kam çfarë të them, më njihni mua". Jose Mourinho mund të emërohet trajner i Real Madridit ose Interit.

Atletico i shtohet garës për Hysajn

Nuk është vetëm skuadra e Chelseat ajo që po interesohet për transferimin e futbollistit shqiptar Elsie Hysajn, pasi për të po interesohet edhe Atletico Madridi. Sipas medieve në Itali, edhe Napoli është gati t'i dëgjojë ofertat që vijnë për Hysajn, kurse një shumë prej 40 milionë eurosh mund ta lëvizte futbollistin kuqezi në një skuadër tjetër.

Malajzia llogarit në shqiptarin Liridon Krasniqi

Liridon Krasniqi nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së famshme Kedah të Malajzisë. Kjo e fundit duket se po mendon që ta angazhojë në të ardhmen futbollistin e Kosovës në përfaqësuesen e vet. Ai është në listën e Federatës së Futbollit të Malajzisë si kandidat potencial për ta veshur fanellën e këtij vendi. Kështu ka bërë me dije zëvendëskryetari i Federatës së Malajzisë, Datuk Yosoff Mahadi. "Kemi një listë të lojtarëve të huaj që po i vëzhgojmë. Liridon Krasniqi është në listën tonë. Lista përbëhet nga lojtarë të huaj që kanë trashëgimi malajziane ose kanë luajtur në vend për katër apo më shumë vjet. Krasniqi është i etur për ta përfaqësuar Malajzinë. Nëse Krasniqi luan edhe një sezon në 'M-League', atëherë ai mund të jetë i kualifikuar", ka thënë Yusoff për "nst.com.my".

Duro kërkon Kupën me Dritën

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Trajneri Shpëtim Duro ka treguar se në fillim kishte hezitim për ta pranuar ofertën e Dritës nga Gjilani. Ai për "Supersport" ka konfirmuar se tash me këtë skuadër e synon trofeun e

Kupës. "E kisha me mëdyshje marrjen e Dritës në ato momente. Ishte moment i vështirë, kishte shumë diferencë me kryesuesit dhe kishte fituar titullin një vit më parë. Deri në këto momente jam

pjesërisht i kënaqur. Fituam shumë ndeshje fillimisht, por rivalët nuk ndaluan. Jemi jashtë luftës për titull, por jemi në garë për Kupën dhe jemi të përqendruar tek ai trofe", ka thënë Duro, duke shtuar: "Kosova tani vonë

luan në Evropë. Nuk krahasohet me nivelin e infrastrukturës me Shqipërinë. Është pozitive që ndeshjet transmetohen. Ka shumë futbollistë dhe e them me bindje se do të ecin shumë në aspektin e rezultateve".



Guardiola: Muriqi është portier i madh

MANCHESTER, 19 DHJETOR - Arijanet Muriq ka qenë lojtari kryesor i Manchester Cityt në ndeshjen e Kupës së Anglisë ku City e eliminoi Leicester Cityn. Reprerentuesi i Kosovës priti dy penallti, kurse trajneri Pep Guardiola e la vlerësuar

lart portierin shqiptar. "Ne arritëm deri në finale sezonin e shkuar, prandaj do të luajmë edhe këtë vit. Tani jemi në gjysmëfinale dhe nuk e dimë si do të shkojë më tej. Ashtu si sezonin e fundit ku i mrekulueshëm ishte Claudio Bravo, këtë

sezon ishte Muriqi. Aro është i madh, ka shumë reflekse dhe mori vendimet e duhura. Kjo ndeshje ishte përvojë e madhe për të. Është i talentuar dhe i turpshëm. Meriton vetëm duartrokitje", ka thënë Guardiola.



Llapi brenda ditës ndahet me Shotanin, merr Rexhepin

PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - KF Llapi është treguar shumë aktiv të mërkurën për faktin se fillimisht e zyrtarizoi mosvazhdimin e bashkëpunimit me trajnerin Bekim Shotani, kurse më pas në konferencë për medie e zyrtarizoi Xhengis Rexhepin si shef të ri të shtabit teknik. Lidhur me mosvazhdimin e bashkëpunimit me trajnerin Shotani, Llapi nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se: "Me marrëveshje të dyanshme mes klubit dhe trajnerit Bekim Shotani të cilit i ka skaduar kontrata me mbylljen e sezonit vjeshtor është mbyllur bashkëpunimi mes dy palëve me pëlqimin edhe të trajnerit për arsyeje familjare".

Ndërsa trajneri nga Shkupi i Maqedonisë, Xhengis Rexhepi, është 36-vjeçar dhe i licencuar me 'UEFA A Pro Licence', kurse më herët ka qenë ndihmëstrajner te skuadra e Sivassporit në Turqi, ndërsa mban edhe postin e ndihmëstrajnerit edhe në Përfaqësuesen e Maqedonisë. "Rexhepi premtoi punë profesionale, disiplinë dhe përkushtim për t'i arritur objektivat të cilat i ka Llapi. Ai ka thënë se ndihet i nderuar që do ta mbaj postin e




trajnerit të një klubi të madh siç është Llapi. Kërkesa e trajnerit Rexhepi ishte përkrahje maksimale nga simpatizuesit e klubit në të gjitha ndeshjet që rruga drejt titullit kampion të jetë më e lehtë dhe e arritshme", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Podujeva. Xhengis Rexhepi do të jetë trajner i tretë në këtë kampionat në

skuadrën e Llapit, pasi më herët ishin edhe Bekim Shotani dhe Bylbyl Sokoli. Llapi e mbylli sezonin vjeshtor në pozitën e tretë me 35 pikë të grumbulluara, pesë më pak se skuadra lidere, Prishtina. Ndërsa kjo skuadër është eliminuar nga gara e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll.

Brooklyn befason lakesat

DOWNTOWN BROOKLYN, 19 TETOR - Skuadra e Brooklynit fitoi 115-110 ndaj lakersave, një fitore e merituar e Netsit, që dominoi në takim. Lakersi u përpoq ta rikthej rezultatin në fund të takimit, me LeBron Jamesin që realizoi 36 pikë e 134 rebounde, por që s'mjaftuan për ta evituar këtë humbje të papritur. Stoli i Brooklyn bëri diferencën në këtë sfidë, me 48 pikë, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte Russell, me 22 pikë e 13 asistime. Fitore në sekondën e fundit për Clevelandin, që mundi 92-91 Indianan, sfidë ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Hood me 17 pikë ishte shënuesi më i mirë për Cavaliersin, duke i bërë të pavlefshme 17 pikët e Sabonisit për Indianan. Fiton edhe Atlanta, që mundi 118-110 Washingtonin, ndeshje e dominuar nga vendësit, me Collinsin që ishte shënuesi më i mirë, autor i 20 pikëve e 13 reboundeve. Ndërsa skuadra e Denverit, falë 32 pikëve e 16 reboundeve të Jokiqit, mundi 126-118 Dallasin.



REZULTATET

Indiana - Cleveland	91-92
Atlanta - Washington	118-110
Brooklyn - Lakers	115-110
Denver - Dallas	128-118

SHKURT

Solskjaeri, trajner i përkohshëm i Unitedit

Norvegjezi Ole Gunnar Solskjaer do të jetë zëvendës i përkohshëm i Jose Mourinhos në postin e trajnerit të Manchester Unitedit. Përkrah tij do të jetë Mike Phelan, ish-asistent i Sir Alex Fergusonit. "Manchester Unitedi është në zemrën time dhe është brilante të kthehem këtu me këtë rol. Mezi pres të punoj me ekipin e talentuar që kemi", ka thënë Solskjaer. Ai ishte futbollist i Unitedit, duke realizuar 126 gola në 366 paraqitjet mes viteve 1996-2007. Në vitin 2008 ai u bë trajner i rezervave të klubit, para se ta merrte drejtimin e Moldes në Norvegji.

Bayerni me çdo kusht e dëshiron Underin

Bayern Munchen po dëshiron ta transferojë në janar sulmuesin e Romës, Cengiz Underin. 21-vjeçari pëlqehet shumë edhe nga Arsenali, Manchester City, Tottenhami dhe Manchester Unitedi, por që "bavarezët" po i prijnë garës. Madje skuadra gjermane ka përgatitur 60 milionë euro. Roma në vitin 2017 e transferoi Underin nga skuadra e Basaksehirit.

Ibrahimoviqi: Erdha këtu për ta mbyllur karrierën, jo për t'u larguar

Zlatan Ibrahimoviqi pritej që të ishte një transferim i Milanit, por ditët e fundit çdo gjë u zyrtarizua dhe 37-vjeçari vendosi përfundimisht të vazhdojë të qëndrojë te Los Angeles Galaxy. "U përfolën shumë gjëra, por unë kurrë nuk u largova. Nuk kam mbaruar ende me MLS-në. Kam akoma gjëra për të bërë. Sezioni im i parë ishte sa për nxehje, sezoni i dytë do të jetë ndryshe. Tani i njoh më mirë kundërshtarët e mi, por edhe kampionatin, për më tepër ndihem më mirë fizikisht. Erdha këtu për ta mbyllur karrierën, jo për t'u larguar", ka thënë Ibrahimoviqi.

City, 86 milionë euro për Iscon

Nën drejtimin e trajnerit Santiago Solari, Isco është kthyer në një lojtar stoli gjatë javëve të fundit. Mesfushori i përfaqësueses spanjolle është i pakënaqur dhe kjo u pa në ndeshjen e fundit të Real, ku u konfrontua edhe me tifozët e klubit. Këtë situatë kërkon ta shfrytëzojë klubi i Pep Guardiolas, Manchester City. Sipas portalit anglez "The Sun", qytetarët i kanë bërë një ofertë të majme "Los Blancos" për fantazistin. Klubi i Premierë Ligës thuhet t'ua ketë ofruar 86 milionë euro kampionëve të Evropës, një shifër interesante që me siguri do të konsiderohet nga Reali. Gjithsesi, klauzola e lirimit të lojtarit spanjoll është 700 milionë euro.

De Laurentis: Refuzova 105 milionë për Koulibaly

Aurelio De Laurentis ka zbuluar një prapaskenë mjaft interesante në lidhje me një ofertë faraonike që ka marrë nga kampionati anglez për transferimin e mbrojtësit senegalez Kalidou Koulibaly. "Kush ka thënë që ne nuk kemi 'top player' në ekip? Unë kam refuzuar 105 milionë euro për Koulibaly. I ka ofruar Mourinho, për ta marrë te Manchester Unitedi dhe unë nuk pranova. Si mund të thoni që nuk kemi lojtarë të mëdhenj", ka deklaruar De Laurentis.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

SHPALLJE

Oglas

Institucioni: Ministria e Infrastrukturës-
Institucija: Ministarstvo Infrastrukture-

Institucioni/institucija MI / MİKërkon të punësojë (titullin e pozitës)
 Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror AshNA / Agjencia za Vazdusne Navigacijske Usluge – AVNU/Air Navigation Services Agency – ANSA, në bazë të Ligjit Nr. 04/L.-250 Për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta: Zëvendës drejtor/eshë për shërbime operative në ASHNA/ Zamenik direktora operative službe - AVNU

(Shënoni saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore) / (Naznačite tačno i kratkim rečima glavne odgovornosti):

- 1. Zëvendës drejtori për shërbime operative punon nën vartësi të Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe do të ketë detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:
 - 1.1. Zëvendës drejtori prioritet më të madh i jep ruajtjes së sigurisë të navigacionit ajror dhe siguron ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësitë të ASHNA-s në pajtim me Ligjin e ASHNA-s, Ligjin për Aviacionin Civil, ligjet tjera dhe aktet relevante nënligjore të Republikës Kosovës, me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian dhe me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara (SPR-të) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;
 - 1.2. Zëvendës drejtori për shërbime operative ndihmon drejtorin në mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve teknike dhe operative që lidhen direkt dhe indirekt me menaxhimin dhe operimin e ASHNA-s;
 - 1.3. Punon me drejtuesit dhe shefat e departamenteve për caktimin e objektivave kryesore dhe realizimin e tyre në mënyrë që të përmbushet siguria dhe zbatimimi i dispozitave ligjore;
 - 1.4. Në koordinim me Zëvendës drejtorin për shërbime administrative financiare bën planifikimin e buxhetit për vitet në vijim;
 - 1.5. Planifikon trajnimet e nevojshme të departamenteve operative.

Nadležnost Zamenik direktora operative službe - AVNU-a

1. Zamenik direktora za operative usluga radi kao podređeni direktora Agencije za Vazdušno Navigacijske Usluge i ima e slede e zadatke i odgovornosti:

1.1. Zamenik direktora daje ve i prioritet očuvanju bezbednosti vazdušne navigacije i obezbeđuje obavljanje nadležnosti i odgovornosti AVNU-a u skladu sa Zakonom AVNU, Zakonom o Civilnom vazduhoplovstvu, drugim zakonima i relevantnim podzakonskim aktima Republike Kosovo, sa relevantnim zakonodavstvom Evropske Unije i Preporučenim standardima i praksama (PSP) Međunarodne organizacije civilnog vazduhoplovstva;

1.2. Zamenik direktora operative službe pomaže direktora u nadgledanju svih tehničkih i operativnih pitanja koja se direktno i indirektno povezuju sa upravljanjem i funkcionisanjem AUVN-a;

1.3. Radi sa rukovodiocima i šefovima odeljenja za određivanje glavnih ciljeva i njihovu realizaciju kako bi se ispunila bezbednost i sprovođenje zakonskih odredbi;

1.4. U koordinaciji sa zamenikom direktora za finansijske administrativne usluge planira budžet za naredne godine;

1.5. planira potrebnu obuku operativnih odeljenja.

Shkollimi i kërkuar/Minimum obrazovanja koje se zahteva:
 (Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/(Navedite stepen obrazovanja koje se realno traži za ovo radno mesto)/

Kualifikimet profesionale

- 1. Një person mund të emërohet Zëvendës drejtor për shërbime operative, nëse ai/ajo posedon kualifikimet në vijim:
 - 1.1. Të këtë diplomë universitare nga një institucion i akredituar akademik, apo një gradë pasuniversitare në fushën e aviacionit civil;
 - 1.2. Të këtë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në menaxhim dhe përvojë profesionale në fushën e aviacionit civil (preferohet përvoja profesionale në fushat teknike të navigacionit ajror si kontrollor i trafikut ajror, inxhinier i pajisjeve të navigacionit, meteorolog i aviacionit etj);
 - 1.3. Të flet rrjedhshëm gjuhën profesionale angleze;
 - 1.4. Të mos ketë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;
 - 1.5. Të mos ketë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë monetar, financiar ose interes tjetër në ndonjë organizatë biznesore që është e angazhuar në sektorin e aviacionit civil dhe të jetë person me integritet të lartë moral dhe profesional.
 - 1.6. Preferohet të këtë njohuri bazë rreth implementimit të SA (safety assesment) në ofruetit e shërbimit të navigacionit ajror (preferohet të këtë trajnime bazë rreth "safety assesment") si dhe këte njohuri bazë rreth shërbimeve të navigacionit ajror (preferohet të këtë trajnime rreth ATC, ATSEP, AIS dhe MET) të dokumentuara me licencë ose çertifikatë.

Profesionalne kvalifikacije:

- 1. Jedno lice može biti imenovano za zamenika direktora za operative službe, ako on ona poseduje slede e kvalifikacije:
 - 1.1. Da ima univerzitetsku diplomu od strane jedne akreditovane akademske institucije ili poslediplomsko obrazovanje u oblasti civilnog vazduhoplovstva;
 - 1.2. Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva u upravljanju i profesionalno iskustvo u oblasti civilnog vazduhoplovstva (poželjno profesionalno iskustvo u tehničkim oblastima

vazdušne navigacije, kao što su kontrolor vazdušnog saobraćaja, inženjer opreme za navigaciju, meteorolog vazduhoplovstva itd);

1.3. Da govori tačno profesionalni engleski jezik;

1.4. Da nije bio osuđivan za neko krivično delo;

1.5. Da nema direktan ili indirektan monetarni, finansijski, ili drugi interes u nekoj poslovnoj organizaciji koja je angažovana u sektoru civilne avijacije i da je osoba sa visokim moralnim i profesionalnim integritetom.

1.6. Da ima osnovno znanje o implementaciji SA (procena sigurnosti) u pružaočima usluga zračne navigacije (poželjno osnovna obuka o "ocjeni sigurnosti"); takođe da ima znanje o uslugama vazduhoplovne navigacije (poželjno obuke o ATC, ATSEP, AIS i MET), dokumentovane sa dozvolom ili certifikatom.

Kohëzgjatja

Zëvendës drejtorët do të shërbejnë me orar të plotë, për një periudhë pesë (5) vjeçare. Me rekomandimin e Ministrisë dhe miratimin e Qeverisë, pas skadimit të mandatit fillestar, ai mund të rrimërohet.

Trajanje

Zamenici direktora e služiti na puno radno vreme, za jedan period od pet (5) godina. Po preporuci Ministra i uz odobrenje Vlade, nakon isteka početnog mandata, mogu biti ponovo imenovani.

Afati i konkurimit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Aplikacioni
2. CV
3. Letër motivimi
4. Dëshmitë e shkollimit dhe trajnimit
5. Vërtetim që kandidati nuk është nën hetime
6. Certifikata e shtetësisë së Republikës së Kosovës
7. Deklaraten nën betim që nuk konflikt interesi

Trajanje ugovora

Zamenik direktora će služiti na puno radno vreme u trajanju od pet (5) godina .

Rok za konkurisanje

Rok za podnošenje prijave je 15 dana od dana objavljivanja konkursa

Dokumentacija za podnošenje zahteva

1. Zahtev za zapošljavanje
2. Biografija
3. Motivaciono pismo
4. Obrazovanje i sertifikati za obuku
5. Potvrda da nije pod istragom od strane vlasti
6. Uvjerenje o državljanstvu Republike Kosova
7. Izjava podzakletvom da ne postoji konflikt interesa.

Kohëzgjatja e emërimit/ Vremenski rok imenovanja:

Kohëzgjatja e kontratës 5 Vjeçare

(Naznačite ako je imenovanje na određeno ili na neodređeno vremei vremenski rok)

(Shënoni kohëzgjatjen e konkursit dhe datën e mbylljes/ Naznačite vremenski rok trajanja konkursa i krajni rok)

Nga 20.12.2018 – 03.01.2019 , deri në ora 16:00/ od 20.12.2018 do 03.01.2019, 16:00 časova

Paraqitja e kërkesave/Prijeva zahteva

(Shënoni vendin ku dhe kur mund të merren formularët e aplikacionit si dhe vendin ku duhet të dorëzohen dhe adresa e plotë e institucionit pranues) / (Navedite kako i gde se mogu dobiti obrasci za konkurisanje, mesto gde ih treba predati kao i tačna adresa institucije koja će ih primiti)

Ministria e Infrastrukturës, Rr. Nëna Terezë, Ndërtesa e ish-Gërmisë, kati II – zryra A 204/ Ministrastvo Infrastrukture, Trg Majka Tereza, Bivša zgrada Germije, II sprat, kancelarija br. A204

Kërkesat specifike/ Specifični zahtevi

(Shënoni nëse ka ndonjë kërkesë specifike shëndetësore ose fizike për kryerjen e detyrave të punës, përfshirë kërkesën për vlerësim mjekorë)/(Navedite ako ima neki specifičan zahtev zdravstvene ili fizičke prirode za izvršavanje radnih obraveza, uključujući zahtev za lekarsko mišljenje).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen /Zahtevi postati nakon zatvaranja konkursa neće se uzeti u obzir. Nekompletirani zahtevi mogu biti odbijeni.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen / Zbog velikog broja dobijenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Shënoni emri dhe mbiemri, numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje / Napišite ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih nedoumica;

Nr (038) 200 28 547ose (038) 200 28 498



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KOMUNA E PRIZRENIT

Kryetari i Komunës

Nr. 01-127/18-1

Datë: 18.12.2018

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 lidhur me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me Ndryshimet dhe Plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dt:28.10.2010, si dhe Ligjit të Procedurës Administrative, Ligji Nr. 05/L-031, Organi Shpronësues merr këtë :

VENDIM PRELIMINAR

I. MIRATOHET- shpronësimi i pronës së paluajtshme të bashkëpronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilët preken për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik – Ndërtimin e Lapidarit-Monumentit në Krushë të Vogël, me të dhënat e përshkruara sipas Kërkesës së parashtruar nga Drejtoria për Administratë me nr.02-464/01-Zyrtar të dt: 03.10.2018. Ngastrada kadastrale e cila do të shpronësohet për realizimin e këtij projekti gjenden në ZK Krushë e Vogël me nr.03087-1 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1656 m², pronë e bashkëpronarëve: ½ Flamur Batusha, kurse Fitim Batusha, Mevlan Batusha, Behar Batusha dhe Rasim Batusha të gjithë me pjesë ideale nga 1/8.

II. Vendimin Preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, Organi shpronësues do t'i njoftojë pronarët, zotëruesit të interesit të pronave si dhe personat tjerë që pretendojnë se i takon një e drejtë në pronën e shpronësuar.

III. Ky Vendim hyn në fuqi brenda 10 ditëve pas miratimit dhe në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

A r s y e t i m

Subjekti Kërkues - Drejtoria për Administratë, me kërkesën e saj të datës 03.10.2018, ka kërkuar inicimin e procedurës së Shpronësimit në lidhje me shpronësimin e ngastrës kadastrale, më qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm publik – Ndërtimin e Lapidarit-Monumentit në Krushë të Vogël ku janë vrarë dhe masakruar 113 persona.

Drejtoria për Administratë, kësaj Kërkesë ia ka bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe i cili parashihet me dispozitën e nenit 8 lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L – 139 të Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimin së të njëjtit ligj Nr.03/L-205, pasi në këtë rast shpronësimi është njëri nga qëllimet e ligjshme publike dhe se në mënyrë të qartë dhe drejtpërdrejtë ky shpronësim është i domosdoshëm për arritjen e të njëjtit qëllim, se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se prona e paluajtshme si objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues i ka përbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

Organi shpronësues – Kryetari i Komunës, me Vendimin Nr. 01-127-18 të datës 30.10.2018, ka miratuar kërkesën e datës 03.10.2018 të subjektit kërkues – Drejtorisë për Administratë për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik.

Më datën 13.11.2018, pronarët – zotëruesit e interesit në pronën e cila do të shpronësohet, në procesverbalin mbi marrjen në pyetje të palës ka deklaruar se nuk është kundër arritjes së qëllimit të ligjshëm publik – Ndërtimin e Lapidarit-Monumentit në Krushë të Vogël.

Organi shpronësues pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi dhe pas vlerësimit të pronave të shpronësuar nga ana e Zyrës për vlerësimin e pronave – Departamenti i Tatimit mbi Pronë - Ministrisë së Financave do të merr Vendimin Përfundimtar për kompensimin e pronës së shpronësuar.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për inicimin e procedurës së shpronësimit dhe se Kërkesa për shpronësim e Subjektit kërkues është e bazuar sipas ligjit në fuqi, u vendos si në dispozitivin e Vendimit dhe në pajtim me nenin 10 lidhur me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me Ndryshimet dhe Plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205.

Udhëzim për mjetin juridik : Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrijë padinë pranë Gjykatës Themelore në Prizren, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohet:
Subjekti kërkues
Arkivi
Pala

Organi Shpronësues:
Kryetari i Komunës

Prof. Dr. Mytaher Haskuka



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PRIZREN BELEDIYESİ

Belediye Başkanı

No. 01-127/18-1

Tarih: 18.12.2018

03/L-205 sayılı 28.10.2010 tarihli Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 10.maddesi 1.fıkrası, ayrıca 05/L-031 sayılı İdari Süreçler Yasası gereğince Kamulaştırma Makamı şu kararı aldı:

Ö N K A R A R

I. Yönetim Müdürlüğün 02-464/01-resmi sayılı ve 03.10.2018 tarihli talebi gereğince tanımlanan verilerle, Küçük Kruşa'da Anıtın İnşaat edilmesi için yasal kamusal amaçlı olarak etkilenen çıkar sahipleri ve ortak mülkiyet sahiplerinin taşınmaz malların kamulaştırılması **KABUL EDİLİYOR**. Bu projenin gerçekleştirilmesi amaçlı kamulaştırılacak olan kadastro parseller 03087-1 sayılı genel alanı 1656m² olan Küçük Kruşa KB şu ortak mülkiyetçileridir: ½ Flamur Batusha, Fitim Batusha, Mevlan Batusha, Behar Batusha ve Rasim Batusha hepsi 1/8 ideal bölüm ile.

II. Onaylandıktan 5 (beş) iş günü içerisinde Ön Karar ile Kamulaştırma Makamı, kamulaştırılan mülkiyette bir hakkın onlara düştüğünü iddia eden mülkiyet sahipleri ve diğer kişileri bilgilendirecektir.

III. Karar onaylandıktan 10 gün sonra ve Kosova Resmi Gazetesinde ayrıca Kosova'nın en yüksek tiraj ile basılan gazetelerinden birinde ilan edildikten sonra yürürlüğe girer.

A ç ı k l a m a

Talep Eden oluşum - Yönetim Müdürlüğü, 03.10.2018 tarihli talebi gereğince tanımlanan Küçük Kruşa'da bu köyden 113 kişinin katledildiği ve hayatını kaybettiği yerde Anıtın İnşaat edilmesi projesinin gerçekleştirilmesi için gerekli olan kadastro parselinde taşınmaz malların kamulaştırılması ile ilişkin Kamulaştırma sürecinin başlatılmasını talep etti.

Yönetim Müdürlüğü işbu talebi sunarken ayısına Kosova Cumhuriyeti'nin 03/L-205 sayılı 28.10.2010 sayılı Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 8.maddesi hükümleri gereğince öngülen gerekli tüm belgeleri de eklemiştir, bu durumda kamulaştırma ile yasal kamusal amaçlardan biri olduğu olduğundan ve bu amacın varılması için bu kamulaştırmanın doğrudan mecburi ve kesin şekilde olduğundan, söz konusu kamulaştırma özel çıkarlara deyindiğinden, kamulaştırma konusu olarak taşınmaz mülkiyet ayrımcılık amaçlı veya hedefli olarak seçilmediğinden ve kamulaştırma makamı da bu yasa gereğince uygulanan tüm hükümleri yerine getirmiştir.

Kamulaştırma Makamı-Belediye Başkanı 01-127-18 sayılı 30.10.2018 tarihli kararı ile 03.10.2018 tarihli Yönetim Müdürlüğün yasa kamusal amacın varılması ve taşınmaz mülkiyetlerin kamulaştırılması ile ilişki talebini kabul etti.

13.11.2018 tarihinde, mülkiyet sahipleri - kamulaştırılacak olan çıkar tarafları, tarafın sorguya alınması ile ilişkin tutanakta Küçük Kruşa'da Anıtın İnşaatı olan yasal kamusal amacın varılmasına karşı olmadığını beyan etti.

Kamulaştırma makamı, işbu Kararın yürürlüğe girmesiyle ve kamulaştırılacak mülkiyetlerin Mülkiyet Değerlerinde Dairesi-Mülkiyet Vergisi Birimi-Maliye Bakanlığı tarafından değerlendirilmesi ardından kamulaştırılan mülkiyetin tafisi için Nihayi Kararı alacaktır.

Bu yüzden kamulaştırma sürecinin başlatılması için yasal tüm koşullar yerine getirildiğinden ve talep eden oluşumun kamulaştırma talebi asıllı bulunduğundan, Kosova Cumhuriyeti'nin 03/L-205 sayılı 28.10.2010 tarihli Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 4.maddesi ile ilişkin 8.maddesi uyarınca işbu Kararın giriş kısmındaki gibi karar verilmiştir.

Hukuki araç talimatı: İşbu Karardan memnun kalmayan taraf, Karar yürürlüğe girdiği andan itibaren 30 günlük süre içerisinde Prizren Asliye Mahkemesine dava sunma hakkına sahiptir.

Karar ile bildirilmeli:
Talep eden oluşum
Arşiv
Taraflar

Kamulaştırma makamı:
Belediye Başkanı

Prof. Dr. Mytaher Haskuka





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumburiyeti

OPŠTINA PRIZREN

Predsednik Opštine

Br. 01-127/18-1

Dana: 18.12.2018



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PRELIMINARNU ODLUKU

I. USVAJA SE – eksproprijacija nepokretnih imovina suvlasnika i nosioca interesa koji se dotiču za postrizanje zakonsko javnih ciljeva – Izgradnja Lapidara – Monument u Maloj Kruši, sa opisanim podacima po Zahtevu dostavljenom od strane Direktorijata Administracije sa br.02-464/01-Službeni od dana 03.10.2018. Katastarske parcele koje će se eksproprijirati za realizaciju ovog projekta nalaze se na KZ Mala Kruša sa br. 03087-1 na opštoj površini od 1656 m², imovina suvlasnika: ½ Flamur Batusha, dok Fitim Batusha, Mevlan Batusha, Behar Batusha i Rasim Batusha svi sa idealnim delom od 1/8.

II. Preliminarna Odluka u toku 5 (pet) radnih dana nakon usvajanja, eksproprijacioni organ će obavestiti vlasnike, nosioce interesa imovina kao i druge osobe koji tvrde da im pripada pravo na eksproprijacionu imovinu.

III. Ova Odluka stupa na snagu u roku od 10 dana nakon usvajanja i na dan objavljivanja u Službenim Novinama Kosova i u jednim novinama sa najvećim tiražom na Kosovu.

Obrazloženje

Traženi Subjektat - Direktorijata Administracije na njen zahtev od dana 03.10.2018, tražio je pokretanje procedure Eksproprijacije u vezi sa eksproprijacijom katastarske parcele u cilju postizanja zakonskog javnog cilja - Izgradnja Lapidara – Monument u Maloj Kruši gde su ubijene i masakrirane 113 osobe.

Direktorijata Administracije, ovom zahtevu je dostavio i svu potrebnu dokumentaciju koja se predviđa dispozitivom člana 8 u vezi sa članom 4 Zakona za Eksproprijaciju Nepokretnih Imovina br. 03/L – 139 Republike Kosova i Izmenu i Dopunu istog zakona br. 03/L-205, pošto u ovom slučaju eksproprijacija je jedan od zakonskih javnih ciljeva i na jasan i direktan način ova eksproprijacija je neophodna za postizanje istog cilja, jer navedena eksproprijacija dotiče privatna prava, jer nepokretna imovina kao objekat eksproprijacije nije izabran za postizanje jednog cilja ili diskriminativnog cilja i da je Eksproprijacioni organ ispunio sve odredbe apliciranja ovog zakona.

Eksproprijacioni organ – Predsednik opštine, sa Odlukom Br. 01-127-18 od dana 30.10.2018, usvojio je zahtev od dana 03.10.2018 traženog subjekta – Direktorijata za Administraciju za eksproprijaciju delova imovina i za postizanje zakonskih javnih ciljeva.

Od dana 13.11.2018, vlasnici – nosioci interesa na imovinu koja će se eksproprijirati, u zapisniku o uzimanju na ispitivanje stranke izjavio je da nije protiv postizanja zakonskog javnog cilja - Izgradnja Lapidara – Monument u Maloj Kruši.

Eksproprijacioni organ nakon pravosnažnosti ove odluke i nakon procenjivanja eksproprijacionih imovina od strane Kancelarije za procenjivanje imovina – Sektor Poreza na Imovinu – Ministarstvo Finansije će doneti Završnu Odluku za nadoknađivanje eksproprijacionih imovina

Stoga znajući da su ispunjeni svi zakonski uslovi za pokretanje eksproprijacione procedure i da zahtev za eksproprijaciju traženog subjekta je osnovan shodno zakonu na snazi, odlučeno je kao u dispozitivu Odluke i u skladu sa članom 10 u vezi sa članom 4 Zakona br.03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretnih Imovina sa izmenama i Dopunama izvršenih Zakonom br. 03/L-205

Uputstvo za pravno sredstvo: Protiv ove Odluke nezadovoljna stranka može da dostavi tužbu pri Osnovnom Sudu u prizrenu, u roku od 30 dana od dana stupanja na snagu ove Odluke.

Ovom Odlukom upoznati:
Traženi Subjektat
Arhivu
Stranku

Eksproprijacioni Organ:
Predsednik opštine
Prof. Dr. Mytaher Haskuka



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Ilaz Mjekiqi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Drenas.
- ▶ Sabahidin Rexhepi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Bajram Curi " Celine
- ▶ Ardiana Hoti shpall te pavlefshme diplomën e shmm " Luciano Motroni " Prizren
- ▶ Jetulla Hoti shpall te pavlefshme deftesat kl VI - IX shf " Bajram Curi " Krush e Madhe
- ▶ Ismajl Shigjeqi shpall te pavlefshme deftesat e shf " Vellezerit Frasheri " Planej
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m². Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmeri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorje me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshohet me qira banesën e mobiluar te saloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshohet banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihen çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshohet banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.
- ▶ Lëshohet garsonierën me qira 13 m² kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister
Agjencia për Barazi Gjinore / Agjencia za Polnu Ravnopravnost / Agency for Gender Equality

Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit shpallë të lirë këtë vend të punës:

1. Një (1) Zyrtar/e Ligjor/e 2.
Numri i referencës: DL-004
Koeficienti: 7

